

**English**

in progress

# ALBATEST

**Instrument për vlerësimin e aftësive gjuhësore në anglisht për moshat 7 - 15 vjeç**

Naxhi Selimi / Emilda Roseni / Shqipe Haxhihyseni

# Impressum

## Autorët

Prof. Dr. Naxhi Selimi

Prof. Asoc. Dr. Emilda Roseni

Prof. Asoc. Dr. Shqipe Haxhihyseni

## Ekspertët

Prof. Dr. Brikena Kadzadej

Prof. em. Dr. Dr. Basil Schader

Prof. Asoc. Dr. Florinda Tarusha

Dr. Spiro Paço

## Redaktimi

M.A. Nuhi Gashi

## Realizimi grafik

M.Sc. Ina Lushka

## © Autorët

Ky instrument me pjesët e tij është i mbrojtur nga e drejta e autorëve. Riprodhimi apo shpërndarja e tij me pagesë është e ndaluar.

Botimi i parë, 2026

Mbështetur nga:



**READ**  
Research Expertise from  
the Academic Diaspora

**ille** The Power  
of International  
Education



Albanian-American  
Development Foundation



**schwyz university of teacher education**

## Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Struktura e instrumentit	4
3. Koncepti i Albatest-it	7
4. Mbështetja e nxënësve sipas nivelit gjuhësor	10
5. Shembuj ilustrues, rekomandime didaktike dhe ide praktike	13
5.1 Dëgjimi	13
5.1.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike	15
5.2 Të folurit	16
5.2.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike	18
5.3 Leximi	20
5.3.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike	24
5.4 Shkrimi	26
5.4.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike	28
6. Udhëzime për përdorimin e formularëve	31
6.1 Formulari <i>Përshkrimi i praktikës gjuhësore</i>	31
6.2 Formularët <i>Dëgjimi, të Folurit, Leximi, Shkrimi</i>	31
7. Shpjegim termash	44
Literatura e përdorur	47

## 1. Hyrje

Mbështetja gjuhësore e nxënësve është efi­kase kur ajo konceptohet në mënyrë shumë­di­men­si­onale dhe bazohet në pa­ri­min e vëzh­gi­mit të shumanshëm (pa­rimi i ‘shumë syve’). Ky pa­rim kërkon një bashkëpunim konstruktiv ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë, të cilët përmes vëzhgimeve personale dhe përdorimit të këtij instrumenti, identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta gjuhësore të nxënësve. Ky hap mundëson një planifikim të mirëfilltë të mbështetjes individuale që merr parasysh nevojat reale të të gjithë nxënësve. Vlerësimi gjithëpërfshirës dhe mbështetja e orientuar drejt nevojave individuale mundësojnë një progres të ndjeshëm dhe sukses në të nxënit e gjuhës në kontekstin shkollor. Në këtë proces luajnë rol të rëndësishëm tekstet mësimore, të cilat ofrojnë mundësi dhe ushtrime të përshtatshme për përmirësimin gradual të aftësive gjuhësore në dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim.

Në funksion të realizimit të vlerësimit real dhe të vlefshëm u hartua Albatest-i, një instrument për vlerësimin formues të aftësive gjuhësore të nxënësve të moshës 7 – 15 vjeç, si për ata me nevoja të veçanta, ashtu edhe për ata pa të tilla. Ai synon të mbështesë nxënësit dhe nxënëset gjatë procesit të të nxënit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj dhe nuk përdoret për vlerësimin përfundimtar. Duhet theksuar se Albatest-i përdoret vetëm kur mësuesi/-ja synon të vlerësojë në mënyrë të saktë përparimin gjuhësor të një nxënësi/-je. Për rrjedhojë, nuk i nënshtrohen testimi të gjithë nxënësit, pasi një praktikë e tillë do ta tejkalonte kornizën kohore të disponueshme. Instrumenti u drejtohet mësuesve, nxënësve, trajnuesve të

studentëve të mësuesisë, si dhe të gjithë atyre që përkrahin nxënësit/-et në të nxënit e gjuhëve.

Instrumenti përfshin një formular për përshkrimin e praktikës gjuhësore dhe katër formularë të tjerë për vlerësimin e aftësive në dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim. Gjithashtu, ai përmban shembuj ilustrues, shpjegime, aspekte didaktike dhe ide për mbështetjen e nxënësve gjatë procesit mësimor. Ai është i ndërtuar në tre nivele dhe bazohet në metodologjinë me tre hapa: vëzhgim, vlerësim, mbështetje.

Albatest-i mbështetet në objektivat e Këshillit të Evropës për gjuhët moderne, në Kornizën e Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (KPER), Lingualevel (për klasat 5–9), në Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ) për moshat 7 deri në 15 vjeç, Sprachgewandt (për klasat 2–9), në kurrikulën dhe materialet mësimore shqiptare, si dhe në përvojën tonë shumëvjeçare në fushën e vlerësimit gjuhësor, hartimit të instrumenteve dhe zhvillimit të planeve mësimore.

Një kriter thelbësor i këtij instrumenti është zbatueshmëria në praktikën mësimore. Për këtë qëllim, u përzgjedhën tregues të rëndësishëm vlerësimi nga instrumente të njohur ndërkombëtarisht (shih bibliografinë) dhe u testua me rreth 200 nxënës dhe nxënëse të arsimit nëntëvjeçar në Shqipëri.

Albatest-i është i qasshëm në formë digjitale dhe ofrohet pa pagesë.

## 2. Struktura e instrumentit

Albatest-i është i strukturuar në tre nivele të progresit gjuhësor:

- **Niveli 1** është përshtatur për nxënës/-e me njohuri fillestare në gjuhën angleze dhe i përgjigjet niveleve A1–A2 sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (KPER).
- **Niveli 2** është përshtatur për nxënës dhe nxënëse me kompetenca mesatare, duke u përputhur me nivelet B1–B2 të KPER-it (përdorim i pavarur i gjuhës).

- **Niveli 3** i drejtohet nxënësve të përparuar në zotërimin e gjuhës në përputhje me nivelet C1–C2 të KPER-it (përdorim kompetent i gjuhës).

**Shënim:** Tre nivelet e gjuhës në këtë instrument shërbejnë vetëm si udhëzues. Supozohet që vetëm një numër i vogël nxënësish të arrijë nivelin 3 (C1–C2) në fusha të caktuara (p.sh. të folurit) deri në fund të klasës së nëntë. Për të shmangur pritshmëri joreale, shumica e nxënësve duhet të synojnë arritjen e nivelit 2 (B1–B2).

Nivelet 1-3, që përshkruhen dhe specifikohen në formularët e Albatesti-t, përkojnë në përgjithësi me këto profile:

### Profili fillestar – Niveli 1, A1-2

Karakteristikat e përdorimit të gjuhës

#### *Fjalori:*

- Fjalori pasiv, aktiv dhe potencial është tepër i kufizuar dhe përmban fjalë të thjeshta të përditshme, të ashtuquajtura ‘chunks’ (frazë të gatshme), me pothuajse asnjë njësi prej më shumë fjalësh që nevojiten në biseda. Pyetjet shpesh përgjigjen me *yes/no [po/jo]*.
- Gjatë përshkrimit të një veprimi, gjendjeje apo situate, nuk përdoren alternativa leksikore, si p.sh. sinonime, antonime, togfjalësha, shprehje me fjali të përbëra etj.
- Ndërimi i kodit (p.sh. anglisht-shqip) është i dukshëm dhe ndikon ndjeshëm në fjalor. Gjatë komunikimit në gjuhën angleze përdoren shpesh fjalë nga gjuha amtare, gjegjësisht fjalët e panjohura në anglisht zëvendësohen me fjalë të gjuhës shqipe.

#### *Gramatika:*

- Gjuha përdoret kryesisht në mënyrë intuitive, ku aspekti morfologjik shpesh nuk merret parasysh. Thjeshtësia sintaksore është lehtësisht e dallueshme, veçanërisht në ndërtimin shumë të kufizuar të fjalive të varura. Pra, përdorimi i gjuhës karakterizohet nga reduktimi sintaksor (p.sh. kombinimi i dy fjalive të thjeshta). Tek fjalitë e shkurtra dhe kryesisht të trajtës pohore, haset shpeshherë një renditje e gabuar e fjalëve.
- Devijimet nga norma gramatikore janë të theksuara (p.sh. rasat, kohët, gjinitë përdoren gabimisht). Në tekstet e nxënësve vërehen gabime drejtshkrimore dhe përdorim i pasaktë i shenjave të pikësimit.

### Profili gjysmë i përparuar – Niveli 2, B1-2

Karakteristikat e përdorimit të gjuhës

#### *Fjalori:*

- Fjalori është mesatar dhe jo i ndërlikuar; nuk përdoren sinonime, antonime, shprehje frazeologjike apo idioma, ndërkaq që janë të pranishme kategoritë leksikore më të zakonshme, si emrat, mbiemrat, përemrat, foljet dhe ndajfoljet.
- Në përmbajtjet abstrakte, që kërkojnë njohuri specifike dhe kompetenca metagjuhësore, fjalori është pjesërisht i dukshëm dhe karakterizohet nga përsëritjet si dhe nga përzgjedhja e kufizuar e njësive leksikore gjatë artikulimit të mendimit.
- Në përgjigje apo pohime shfaqen fjali të izoluara të vendosura pranë njëra-tjetrës, të cilat, megjithëse të ndara në ndërtim sintaksor, krijojnë kuptim të qartë në kontekstin e përgjithshëm dhe përçojnë informacion relativisht të saktë në aspektin semantik.
- Përtej lidhëzës *and* përdoren edhe lidhëza të tjera, kryesisht ato me funksion kundërshtues, të cilat përmes krijimit të kontrasteve mes përmbajtjeve të fjalive të nënrenditura kontribuojnë në një shprehje më dinamike dhe koherente.
- Ndërrimi i kodeve gjuhësore shfaqet kryesisht në fjalitë e ndërlikuara, ku kalimi nga anglishtja në gjuhën shqipe ndodh në mes ose në fund të fjalisë. Ky fenomen është i dallueshëm, por dukshëm më i rrallë krahasuar me profilin fillestar.

#### *Gramatika:*

- Pjesët e ligjëratës (emrat, mbiemrat, numërorët, nyjat) lakohen sipas normës, ndërsa përdorimi i përemrave shpesh nuk është në përputhje me rregullat gjuhësore. Foljet në përgjithësi zgjedhohen saktë. Fjalitë e pavarura përdoren më shpesh dhe janë më të njëtrajtshme në ndërtim sesa fjalitë e varura.
- Në përgjithësi, mbizotërojnë fjalitë e thjeshta në krahasim me kombinime fjalish të përbëra (të pavarura – të varura), edhe pse këto të fundit paraqiten në nivele të ndryshme.
- Vërehen vështirësi gjatë përdorimit të fjalive me nënrenditje pjesore dhe kushtore; herë pas here mungon folja ose ndodh një bashkim i pasaktë ndërmjet fjalive të pavarura dhe atyre të varura. Në tekstet e shkruara hasen gabime drejtshkrimore.

### **Profili i përparuar – Niveli 3, C1-2**

#### Karakteristikat e përdorimit të gjuhës

#### *Fjalori:*

- Fjalori është relativisht i pasur dhe përfshin kombinime të kuptueshme e me lidhje logjike të fjalive të varura dhe të pavarura, si dhe larmi strukturash sintaksore, përfshirë fjali dëftore, urdhërore, dëshirore, pyetëse dhe thirrrore. Gjatë përshkrimit të një situatë, gjendjeje apo objekti përdoren shprehje të përshtatshme, ku evidentohen sinonime, antonime, idioma apo fraza të ndryshme.
- Në komunikimin me gojë dhe me shkrim përdoren qëllimisht strategji gjuhësore të përshtatshme. Ndërrimi i kodit është shumë i rrallë. Përrjashtim bëjnë termat e përcaktuar si *Sheshi Skënderbej*. Tekstet me gojë dhe me shkrim përmbajnë si fjali të thjeshta, ashtu edhe të përbëra, me përdorim të formave të plota të foljeve (veprore dhe ndihmëse), ndajfoljeve të vendit, kohës, shkakut dhe pyetëse, duke ruajtur një rrjedhë kronologjike dhe dinamike.

#### *Gramatika:*

- Pjesët e ligjëratës (emrat, nyjat, mbiemrat, numërorët, foljet), llojet dhe tipat e fjalive të përmendura më sipër dhe kohët e foljes (nga e tashmja deri tek e ardhmja) përdoren në mënyrë të përshtatshme në raport me kontekstin, si nga pikëpamja morfologjike, ashtu edhe nga ajo sintaksore.
- Gabimet gjatë ndërtimit të fjalive janë dukshëm më të pakta, krahasuar me profilin fillestar.
- Tekstet e shkruara përmbajnë shumë pak gabime drejtshkrimore ose përdorime të papërshtatshme të shenjave të pikësimit.

### 3. Koncepti i Albatest-it

Të nxënit e gjuhës në shkollë përbën një tërësi të integruar, që përfshin disa fusha të organizuara në dy kategori kryesore komunikimi: me gojë dhe me shkrim. Në kontekstin e mësimdhënies së gjuhës, dëgjimi, të folurit, leximi dhe shkrimi – sado të zakonshme që mund të duken – kanë rëndësi thelbësore. Këto janë katër mënyra të ndryshme të qasjes ndaj gjuhës, secila me kërkesat e veta fizike dhe intelektuale për nxënësit/-et. Këto fusha ndërlidhen dhe ndërveprojnë me njëra-tjetrën; për shembull, procesi i të shkruarit zakonisht përfshin edhe elemente të dëgjimit, leximit dhe të të folurit.

Këto fusha, të përfshira në planin mësimor dhe në tekstet mësimore, ndërthuren me disiplinat gjuhësore si fonetika, fonologjia, leksikologjia, semantika, pragmatika, analiza e diskursit, letërsia, metagjuha, si dhe me dimensione të tjera të rëndësishme si përdorimi i vetëdijshëm i gjuhës gjatë mësimdhënies, orientimi drejt kompetencave dhe vlerësimi i kompetencave gjuhësore të nxënësve. Të gjitha këto së bashku përbëjnë atë që njihet si *gjuha akademike*, e cila është vendimtare për suksesin e nxënësve në shkollë dhe në jetën e përditshme (shih ilustrimin më poshtë).

Albatest-i mbështetet në këtë koncept dhe vë në qendër fushat themelore të gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit,

të cilat e karakterizojnë përditshmërinë mësimore.


**Dëgjimi** është, ndoshta, aftësia më të cilën njeriu përballet më shpesh gjatë jetës së përditshme. Ai përbën themelin mbi të cilin ndërtohen dhe zhvillohen të gjitha aftësitë e tjera gjuhësore. Nëse një nxënës/-e ka vështirësi ta kuptojë atë që dëgjon, pritjet të përballet me vështirësi edhe në zotërimin e aftësive të tjera të të nxënit gjuhësor. Të kuptuarit gjatë dëgjimit nënkupton njohjen, dallimin dhe përvetësimin e tingujve të të folurit. Dëgjimi lidhet gjithashtu me elementë joverbalë të komunikimit si mimika, gjestet ose ironia.

Aftësia për të dëgjuar, si pjesë thelbësore e procesit të të nxënit, nuk zhvillohet në mënyrë të natyrshme, por kërkon një trajtim të qëllimshëm dhe sistematik gjatë orëve mësimore, në mënyrë që të arrihen këto rezultate:

- a) zhvillimi i aftësive leksikore dhe semantike përmes pasurimit të fjalorit dhe kuptimit të saktë të fjalëve në varësi të kontekstit;
- b) përvetësimi i njohurive gramatikore që përfshin njohjen e tingujve, zgjedhimin dhe lakimin e fjalëve dhe strukturën sintaksore të fjalive;

- c) zhvillimi i aftësisë për të interpretuar dhe shpjeguar në mënyrë të saktë përmbajtjen e dëgjuar;
- d) formimi i kompetencave sociokulturore dhe sociolinguistike, përfshirë përdorimin e përhëndetjeve, përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet folësve, si dhe njohjen dhe interpretimin e veçorive

paraverbale (intonacioni, theksi, ritmi, pauzat) dhe joverbale (gjestet, mimika, qëndrimi i trupit) që shoqërojnë të folurit.



**Të folurit** përfshin prodhimin e tingujve që bashkohen për të formuar fjalë dhe njësi kuptimplota të gjuhës. Ky është një proces kompleks fiziologjik, ku sistemi nervor i folësit parashikon tingujt që do të artikulohen

dhe, njëkohësisht, monitoron prodhimin e tyre përmes mekanizmit të dëgjimit.

Nga këndvështrimi didaktik, të gjitha aktivitetet që lidhen me të folurit dhe që bazohen në planin mësimor janë të

justifikueshme, nëse ato nxisin forma të ndryshme të komunikimit me gojë dhe marrin në konsideratë përvojat dhe nevojat e nxënësve. Në këtë fushë përfshihen: bisedat në klasë mbi zgjidhjen e pyetjeve që lidhen me fenomenet e të folurit, bisedat këshilluese, diskutimet për planifikimin dhe zbatimin e një projekti, si dhe aktivitete të tjera që i shërbejnë zhvillimit të dijes, aftësive, motivimit dhe interesave të nxënësve. Në këtë kontekst, tekstet mësimore ofrojnë një gamë të gjerë mundësish për të përmirësuar të folurit në kontekste të ndryshme mësimore.

Kompetenca komunikuese e mësuesve, roli i tyre si model gjuhësor dhe aftësia për të ndërmjetësuar në mënyrë të vetëdijshme gjuhën e folur janë faktorë thelbësorë për të nxitur motivimin dhe për të mbështetur përparimin e nxënësve në këtë fushë gjuhësore. Falë kompetencës gjuhësore dhe didaktike të mësuesve, nxënësit/-et, pavarësisht nëse janë ekstrovertë ose introvertë, inkurajohen të shprehen lirshëm, të planifikojnë një fjalim argumentues, të bazuar në fakte dhe me qëndrim të qartë, që lidhet me objektivat e planifikuara mësimore.

**Leximi** përfshin procesin e njohjes, dallimit, përvetësimit dhe riprodhimit të shenjave gjuhësore vizuale, qoftë në heshtje apo me zë. Ai nënkupton zotërimin e aftësisë për t'u dhënë kuptim simboleve grafike dhe për të ndërtuar ose nxjerrë kuptim prej tyre.

Mjedisi i të nxënësve, nxitja dhe kultura e të lexuarit përbëjnë trekëndëshin themelor të didaktikës së leximit. Përveç ndikimit të familjes, roli model i mësuesit/-es është një faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij procesi. Të lexuarit në një atmosferë të këndshme gjatë orës së mësimi perceptohet nga nxënësit si një përjetim pozitiv dhe i vlefshëm. Nxënësit/-et kanë nevojë për

hapësira kohore që tejkalojnë kufijtë e orës mësimore. Krijimi i një këndi leximi në klasë, i pasuruar me libra të përshtatshëm, ose mbajtja e një ditari leximi, që përfshin përmbledhje, vlerësime personale dhe ilustrime të frymëzuara nga teksti, ndikon pozitivisht në motivimin dhe përfshirjen e tyre në procesin e leximit.

**Shkrimi** u mundëson nxënësve shndërrimin e mendimeve në shenja të dukshme grafike. Në thelb, ai përfaqëson të folurit përmes simboleve të shkruara, të cilave u janë caktuar tinguj dhe kuptime të veçanta gjuhësore. Përmes kësaj aftësie, nxënësit/-et janë në gjendje të ndërtojnë në mënyrë aktive lidhje të ndërlikuara, duke planifikuar, formuluar, modifikuar apo riformuluar tekste të shkruara. Në kuadër të didaktikës së të shkruarit, mësuesit/-et krijojnë një mjedis të favorshëm mësimor dhe nxisin krijimtarinë e nxënësve në të shkruar. Ata i inkurajojnë nxënësit/-et të hartojnë tekste që paraqesin situata reale ose të imagjinuara, në formë posteri, teksti informues, e-maili, teksti letrar, poezie, ditari apo letre personale.

Në këtë proces, mjedisi i të shkruarit, kujtesa afatgjatë e nxënësit/-es që shkruan dhe vetë procesi i të shkruarit përbëjnë tre elementët kyç që ndërthuren midis proceseve të brendshme të të shkruarit dhe kushteve të jashtme që e ndikojnë atë. Megjithatë, ky proces kërkon që nxënësit/-et të kenë njohuri dhe informacione paraprake lidhur me temën dhe llojin e tekstit që do të shkruajnë, formën e shprehjes që duan të përdorin për tekstin, qëllimin dhe audiencën që synojnë, kohën që kanë në dispozicion si dhe strategjitë për të kapërcyer vështirësitë gjatë procesit të të shkruarit (për shembull ese, diktim, tekst eksplorues, komunikues, krijues, personal) si edhe zgjedhjen e mjeteve dhe medieve mbështetëse që do të përdoren gjatë procesit.

**Fjalori** përbën një parakusht thelbësor për të kuptuar tekstet dhe për t'u shprehur qartë, si me gojë ashtu edhe me shkrim. Ai nuk zhvillohet në mënyrë të vetvetishme vetëm përmes leximit apo dëgjimit, por kërkon një proces të vazhdueshëm dhe sistematik pune. Mësimi i fjalëve në mënyrë të izoluar nuk është i mjaftueshëm. Nxënësit/-et duhet të aftësohen për të nxënë kuptimet e fjalëve dhe t'i përdorin ato në mënyrë të përshtatshme në kontekste të ndryshme.

**Reflektimi** mbi fenomenet gjuhësore shkon përtej **gramatikës** tradicionale, e cila fokusohet kryesisht te fjalëformimi (morfologjia) dhe ndërtimi i fjalive (sintaksa). Ky reflektim përfshin gjithashtu edhe

elemente si gjestet, mimika, intonacioni i zërit, simbolet apo piktogramet. Një qasje e tillë ndihmon në zhvillimin e ndjeshmërisë gjuhësore dhe të aftësive komunikuese të nxënësve.

**Drejtshkrimi** paraqet zotërimin e të shkruarit të gjuhës në mënyrë sistematike përmes shkronjave dhe shenjave të pikësimit. Edhe pse të mësuarit e anglishtes si gjuhë e huaj shpeshherë përqendrohet te komunikimi, aftësitë në drejtshkrim formojnë tek nxënësit strukturën e brendshme të rregullave gjuhësore dhe i ndihmojnë ata të njohin dhe të përdorin strukturat gramatikore gjatë leximit dhe shkrimit.

#### 4. Mbështetja e nxënësve sipas nivelit gjuhësor

Vështirësia e detyrave për mbështetje individuale rritet në përputhje me tre nivelet gjuhësore të Albatest-it. Njëpërmjet përfshirjes aktive dhe të vazhdueshme gjatë trajtimit të temave të ndryshme, nxënësit/-et zhvillojnë gradualisht aftësitë e tyre gjuhësore. Duke marrë në konsideratë fushat, nivelet respektive dhe profilet e lartpërmendura, mbështetja e nxënësve në gjuhën e folur dhe të shkruar karakterizohet nga këto aspekte:

<b>Gjuha e folur</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Aspekte të mbështetjes</b>
<b>1 (A1-2)</b>	Duhet të mbështeten aftësitë bazë të dëgjimit dhe të të folurit (përdorimi i fjalëve dhe fjalive të thjeshta) që lidhen me mjedisin e nxënësve: familja, rrobat, ngjyrat, shkolla, koha, numrat etj. Në fillim, nxënësit duhet të fitojnë ndjesi receptive (dëgjim, lexim) dhe produktive (të folur, shkrim) për gjuhën (në këtë rast anglishten). Kjo i ndihmon ata që të ndërtojnë ndërgjegjësimin fonologjik (perceptimi, segmentimi dhe shqiptimi i tingujve), fjalorin bazë prej rreth 400 fjalësh) dhe përvojat fillestare me strukturën e gjuhës (gramatikën). Sipas kërkesave të pritshme të të nxënësve, që përfshihen në planin mësimor, nxënësit/-et me nevoja të veçanta pritet që në përfundim të arsimit nëntëvjeçar të arrijnë një nivel gjuhësor që përshtatet me aftësitë e tyre individuale. Për këtë kategori nxënësish/-es synohet një fjalor bazë, duke filluar nga rreth 200 fjalë në klasat e ciklit të ulët e deri në rreth 500 – 800 fjalë në klasat e ciklit të lartë. Shembuj për këtë ofrojnë tekstet mësimore 'Young Stars' (shih edhe kornizën kurrikulare, linku gjendet në bibliografi).

<p><b>2 (B1-2)</b></p>	<p>Nxënësit/-et i zhvillojnë më tej kompetencat e tyre gjuhësore dhe e përforcojnë fjalorin bazë. Njëkohësisht, ata zgjerojnë aftësitë e të shprehurit dhe i zbatojnë ato gjatë përdorimit të temave të përditshme: hobi, pushime, festa, aktivitete gjatë kohës së lirë, muzikë, sport, rutina ditore etj. Janë tema të njohura dhe lehtë të kuptueshme që i ndihmojnë të shprehen. Zakonisht, nxënësit/-et e këtij niveli zotërojnë, në varësi të moshës dhe aftësive të tyre gjuhësore, një fjalor prej rreth 2000 fjalësh. Shembuj për këtë gjenden në ‘Young Stars 4’ dhe ‘New Challenges 1’.</p>
<p><b>3 (C1-2)</b></p>	<p>Nxënësit/-et janë në gjendje të përballen me përmbajtje të ndërlikuara sfiduese dhe e thellojnë fjalorin e tyre si në aspektin receptiv, ashtu edhe në atë produktiv, por njëkohësisht edhe aftësitë gramatikore dhe letrare. Ata zotërojnë 4000 e më tepër fjalë. Qëllimi është që ta kuptojnë përmbajtjen e temave të ndryshme, ta shpjegojnë atë me një fjalor të pasur, të përdorin strategjitë e duhura dhe t’i shprehin qëndrimet e tyre personale rreth një teme të caktuar. Sekuencat e dëgjimit dhe të folurit në formë monologu apo dialogu janë të larmishme dhe e mundësojnë ndjekjen e tregimeve, marrjen në konsideratë të thënieve të mëparshme, tregimin vetjak, përfshirjen në bisedë, përdorimin e vetëdijshëm të elementeve joverbale ose paraverbale, si dhe shqiptimin e fjalëve. Për këtë qëllim mund të përdoren tekstet ‘New Challenges’ 2 dhe 3 (p.sh. për temat our world, life stories, mysteries, performers, technology, holidays). Këtu duhet merren parasysh të gjitha tekstet e miratuara nga Ministria e Arsimit. Tekstet që përmenden në këtë manual janë përzgjedhur si shembuj për qëllime studimi.</p>
<p><b>Gjuha e shkruar</b></p>	
<p><b>1 (A1-2)</b></p>	<p>Nxënësit/-et duhet të inkurajohen të lexojnë çdo ditë tekste me përmbajtje dhe fjalor të thjeshtë dhe njëkohësisht të përvetësojnë strategji që mbështesin të kuptuarit gjatë leximit, p.sh. nënvizimi i fjalëve kyçe apo fokusimi tek mesazhi kryesor i tekstit që trajtojnë. Në sekuenca prej pesë deri në dhjetë minuta, nxënësit/-et shkruajnë fjali dhe fraza të izoluar, si p.sh. <i>I am Marlon. I love football. I love Durrës</i> ose përdorin lidhëza të zakonshme si <i>and, or, because</i>. Këto struktura të njohura kontribuojnë në ndërtimin e fjalive dhe të grupeve të fjalëve. Përdorimi i lidhëzave të zakonshme i inkurajon nxënësit/-et të ndërtojnë shprehje lineare. Për të siguruar koherencën, ushtrojnë përdorimin e treguesve deiktikë si <i>here, there, then</i> ose plotësimeve lokale, temporale, kausale, modale, pra: <i>ku, kur, pse, si</i>. Njëkohësisht përdorin emra dhe folje të zakonshme. Këto aspekte mund të ushtrohen me ndihmën e teksteve mësimore të anglishtes.</p>
<p><b>2 (B1-2)</b></p>	<p>Nxënësit/-et lexojnë tekste të ndryshme (të përditshme, informuese, letrare) dhe përdorin strategji të duhura gjatë leximit. Ata shkruajnë tekste të shkurtra që lidhen me përvojat e tyre personale. Kështu mësojnë t’i shprehin qartë</p>

	<p>mendimet e tyre dhe të paraqesin fakte të shoqëruara me detaje apo shembuj konkretë dhe koherentë, si p.sh. <i>I am Marlon, I am ten years old. I like football. My favorite player is Lorik.</i> Në këtë mënyrë përdorin lidhëza si <i>where, why, after, then</i> dhe përforcojnë fjalorin, duke përdorur fjalë të reja. Në gramatikë ushtrojnë renditjen e foljeve dhe drejtshkrimin, duke rishikuar dhe korrigjuar tekstet e tyre. Ushtrime për këtë gjenden në ‘New Challenges’ 1, 2 dhe 3.</p>
<p><b>3 (C1-2)</b></p>	<p>Nxënësit/-et e përparuar i thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të kuptuar përmbajtjen e teksteve të ndërlikuara që i përkasin zhanreve të ndryshme: informuese, letrare, argumentuese, etj. Ata i përmirësojnë tekstet e tyre sipas qëllimit që ndjekin, i përshtatin sipas situatës dhe audiencës, mësojnë të riformulojnë dhe të sqarojnë dykuptimësinë ose shumëkuptimësinë, të strukturojnë mendimet, duke i ilustruar me shembuj dhe t’i ndërlidhin aspektet tematike. Në lidhje me gramatikën, drejtshkrimin dhe materialet mbështetëse shih përshkrimin në nivelin 2 (B1–2).</p>
<p><b>Shënim:</b> Dëgjimi, të folurit, leximi dhe shkrimi lidhen ngushtë me fjalorin dhe mënyrën se si nxënësit/-et i trajtojnë tekstet me gojë dhe me shkrim. Për shembull, gjatë të shkruarit, ata përdorin njohuritë që kanë fituar nga dëgjimi, leximi dhe të folurit. Të kuptuarit e një bisede apo teksti varet shumë nga thesari i fjalëve që zotëron një nxënës/-e. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se përvetësimi i <i>gjuhës akademike</i> (njohuritë gjuhësore akademike – <i>Cognitive Academic Language Proficiency, CALP</i>) kërkon zakonisht nga 7 deri në 10 vjet punë të vazhdueshme. Ndërkohë, përvetësimi i gjuhës së përditshme të komunikimit (aftësitë bazë ndërpersonale të komunikimit – <i>Basic Interpersonal Communication Skills, BICS</i>), e cila përdoret në situata të zakonshme të përditshme, mund të arrihet për rreth 2 vjet. Kjo është edhe arsyeja pse ndodh që një nxënës/-e të shprehet rrjedhshëm në biseda të rëndomta, por të ketë vështirësi në kuptimin e një teksti të thjeshtë mësimit. Preferencat individuale janë një faktor tjetër i rëndësishëm për mënyrën e të mësuarit: dikush mëson më mirë përmes të folurit, dikush përmes leximit ose dëgjimit.</p> <p>Duhet pasur parasysh edhe fakti që fjalori receptiv (pasiv) është shumëfish më i gjerë se ai produktiv (aktiv). Nxënësit/-et në vitet e para të shkollës fillore zotërojnë në gjuhën amtare rreth 5,000 fjalë në mënyrë aktive dhe rreth 14,000 fjalë në mënyrë pasive. Çdo vit shkollor, ata mësojnë deri në 3,000 fjalë të reja dhe e zgjerojnë fjalorin e tyre aktiv deri në 15,000 fjalë, kurse ai receptiv shkon deri në mbi 70,000 fjalë.</p> <p><b>Ndërrhyrje sqaruese:</b> Një analizë e teksteve shkollore në Gjermani tregoi se nxënësit e klasës së dytë përballen me rreth 3,700 fjalë, ndërsa në klasën e tretë me rreth 7,300 fjalë. Nëse një fëmijë në këtë moshë zotëron një fjalor aktiv prej afërsisht 5,000 fjalësh, ai është në gjendje ta përballojë këtë sfidë, pasi shumë prej fjalëve janë tashmë të njohura ose mund të kuptohen nga konteksti.</p> <p>Sa i përket mësimit të gjuhëve të huaja, sidomos në kontekstin e arsimit për nxënësit/-et me nevoja të veçanta, nuk mund të pritet që të gjithë, në përfundim të shkollës nëntëvjeçare të zotërojnë një fjalor prej 400–800 fjalësh në gjuhën angleze si gjuhë e huaj, sepse procesi i përvetësimit të fjalëve kërkon kohë dhe ndodh në mënyrë graduale. Mësimi i një fjale kalon në disa faza: Në fazën e parë, nxënësi/-ja përdor një fjalë deri në 30 herë, në mënyrë që ta kuptojë përafërsisht kuptimin e saj,</p>	

por pa qenë ende në gjendje ta përdorë saktë. Në fazën e dytë, nxënësi/-ja e lidh kuptimin e fjalës me kontekstin në të cilin ajo përdoret, duke e përsëritur atë edhe 20 herë të tjera. Në fazën e tretë, nxënësi/-ja është në gjendje t'i përdorë fjalët e mësuara me siguri si në të folur, ashtu edhe në të shkruar. Pra, numri më i madh i fjalëve duhet të përdoren deri në 70 herë, para se të zotërohen plotësisht.

## 5. Shembuj ilustrues, rekomandime didaktike dhe ide praktike

Në këtë kapitull paraqiten disa shembuj, rekomandime dhe ide për veprimtari praktike dhe lojëra didaktike, të cilat mësuesi/-ja mund t'i zhvillojë gjatë orëve të mësimi, në funksion të zhvillimit të aftësive gjuhësore të nxënësve. Gjithashtu, ofrohen edhe disa udhëzime shtesë që duhet të merren parasysh gjatë procesit të zhvillimit të këtyre aftësive.

### 5.1 Dëgjimi

#### Shembull për klasën e 8-të

**Konteksti tematik dhe detyra mësimore:** Një studente nga Londra dëshiron të bëjë praktikën si mësuese asistente në klasën e 8-të të një shkolle në Durrës. Ajo i dërgon nxënëses me të cilën mban kontakte një mesazh zanor urgjent gjatë orës së mësimi, duke i kërkuar që t'i përshkruajë rrugën për në shkolle (shih më poshtë). Shënim: Në këtë kontekst, nxënësit angazhohen në një situatë dëgjimi dhe të foluri në formë monologu.

**Sugjerim:** Për zhvillimin e aftësisë së të dëgjuarit përshtaten sekuencat e shkurtra audio të përfshira në tekstet mësimore. Për të krijuar një panoramë të qartë mbi nivelin e aftësive në fushën e dëgjimit, mësuesi/-ja fillimisht prezanton një material auditiv të shkurtër dhe u kërkon nxënësve të dëgjojnë me vëmendje. Më pas, ai/ajo fton një ose më shumë nxënës të riprodhojnë me fjalët e tyre përmbajtjen e tekstit të dëgjuar. Në rast se nxënësi/-ja ka vështirësi për të rikujtuar apo për të strukturuar informacionin e dëgjuar, mësuesi/-ja mund të ndihmojë, duke përsëritur përmbajtjen e tekstit ose duke bërë pyetje orientuese: *Çfarë dëgjove? Për çfarë bëhej fjalë në mesazhin e dëgjuar? Çfarë ndodhi?* Nëse nxënësi/-ja arrin të përmbledhë rrjedhshëm përmbajtjen, kjo tregon se ai/ajo ka aftësi të mira dëgjimi. Nëse jep përgjigje vetëm pas ndërhyrjes ndihmëse të mësuesit/-es, ky është një tregues i aftësive të kufizuara në dëgjim dhe përbën një pikënisje të vlefshme për planifikimin e ndërhyrjeve të mëtejshme gjuhësore dhe didaktike.

<b>Praktikantja Johana (20 vjeçe):</b>	<i>Hello, I'm Johana, the teacher trainee from London. I'm on my way to school right now, but I can't find the way. Can you please leave me a message telling me how to get to school on foot. Thank you and see you then!</i>
<b>Nxënësjja Rea (15 vjeçe):</b>	<i>Hello Ms. Clark. We are glad that you come to visit us. When you arrive at the station is oposit the post. And beside of the post is Rruga e Tiranës. And there you must turn right. Now you must all go straight on. Now see you e little road and there you must go in and all go</i>

	<p><i>straight on. Now see you the main road and this you must only cross. Now are you here.</i></p>
<p><b>Vlerësim i aftësisë së të dëgjuarit sipas formularit përkatës:</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b> Përshkrimi i nxënësës është i kuptueshëm. Supozohet se praktikantja, bazuar në këtë udhëzim, do të jetë në gjendje të gjejë shkollën pa vështirësi. Nxënësja jep informacionet thelbësore që shërbejnë si orientuese për të arritur në destinacion.</p> <p><b>Gjuha:</b> Gjuha e përdorur është e thjeshtë, por përmban disa pasaktësi, kryesisht në ndërtimin sintaksor të fjalisë: p.sh. <i>see you</i> në vend të <i>you see</i>; <i>When you arrive at the station is oposit the post</i> në vend të <i>When you arrive at the station, you will see the post office opposite</i>. Fillimi i fjalisë me lidhëza apo shenja deiktike si <i>and, now</i> është i panevojshëm; më të përshtatshme do të ishin forma si <i>then</i> apo <i>there is</i>. Përdorimi i përemrit <i>you</i> në ndërtimin e udhëzimeve nuk është në vetvete i pasaktë, por nuk përkon me anglishten standarde të shkruar. Një version më i natyrshëm për fjalinë e fundit mund të ishte: <i>Then you have arrived / reached the school / are at the school</i>. Duke u bazuar në këto vlerësime, cilësia gjuhësore e përgjithshme e nxënësës i përgjigjet <b>nivelit 1, A2</b> sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët.</p> <p><b>Nevoja për mbështetje:</b> Mesazhi zanor dëshmon se nxënësja e ka kuptuar në vija të përgjithshme mesazhin e praktikantes. Megjithatë, përgjigja e saj tregon se ka ende nevojë për mbështetje. Ajo është në gjendje të kuptojë mesazhe të thjeshta përmes kontekstit, por duhet ndihmuar që ta kuptojë edhe informacionin implicit dhe, gradualisht, të përballojë situata receptive, qofshin ato monologë apo dialogë (p.sh. biseda telefonike, pjesë teatrore, filma, radiodrama). Me mbështetje të përshtatshme individuale, ajo do të aftësohet të bëjë pyetje të detajuara dhe me qëllim specifik, të dallojë dhe interpretojë biseda emocionale si lëndimi, zemërimi, gëzimi dhe të vlerësojë sjelljen në debate, duke treguar aftësi pragmatike dhe diskursive, si dhe të përdorë strategji të përshtatshme në komunikim. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i pyetjeve nxitëse që jo vetëm ndihmojnë në kuptimin e asaj që është thënë, por inkurajojnë për të reflektuar mbi efektin e argumenteve dhe ideve të ndryshme.</p>	

### 5.1.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike

- Mësuesit/-et e përmbledhin thelbin e temës në mënyrë të saktë, shmangin përsëritjet e panevojshme dhe i shpjegojnë përmbajtjet në një gjuhë të kuptueshme për nxënësit, duke mos përdorur fjali të ndërlikuara.
- Ata i inkurajojnë nxënësit që t'i shprehin mendimet në mënyrë të kuptueshme, me qëllim që të zgjojnë interesin e dëgjuesve.
- Nxënësit i njohin format dhe stilet e ndryshme të dëgjimit dhe e dinë se në të dëgjuarit e përgjithshëm synohet të kuptohen mesazhet kryesore dhe të krijohet një ide e përgjithshme mbi përmbajtjen, në të dëgjuarit selektiv nxirren vetëm informacione të caktuara, në të dëgjuarit e detajuar synohet të kuptohen saktësisht detaje (p.sh. numra apo fakte) në të dëgjuarit diskriminues dëgjojnë atë që u intereson apo, më saktë, atë që duan të dëgjojnë.
- Mësuesit/-et krijojnë situata të volitshme me pajisje audio-vizuale që e lehtësojnë nxënien e përmbajtjes së sekuencave të dëgjimit dhe i ndihmojnë nxënësit/-et të dallojnë midis dëgjimit si monolog (p.sh.

njoftime, lajme, prezantime të shkurtra, mesazhe në sekretarinë telefonike etj.) dhe *dëgjimit si dialog* (p.sh. biseda të përditshme, biseda telefonike, intervista, diskutime në çifte apo në grup).

Në varësi të kompetencës gjuhësore, nxënësit/-et nuk e kuptojnë plotësisht atë që dëgjojnë, prandaj mësuesit/-et ofrojnë kushte për të analizuar, krahasuar, interpretuar, përmbledhur dhe mësuar përmbajtjen. Për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit rekomandohen aktivitete kreative. Ja disa shembuj:

**Lojëra enigmatike:** Një nxënëse fillon me një enigmë që lidhet me një profesion të caktuar, p.sh. atë të bukëpjekësit. Nxënësit, që dëgjojnë, bëjnë pyetje: *Does he get up early in the morning? Does he wear a white T-shirt? Does he work with hands and machines? Does he have a big oven?* etj.

**Meditime auditive:** Nxënësit/-et vëzhgojnë një objekt dhe më pas i mbyllin sytë. Mësuesi/-ja lexon me zë të ulët një tekst që përshkruan objektin. Më pas, nxënësve u kërkohet të shpjegojnë çfarë kanë kuptuar nga materiali i dëgjuar.

**Fjalë të pëshpëritura:** Të gjithë ulen në formë rrethi dhe dëgjojnë me vëmendje. Mësuesi/-ja pëshpërit një fjalë, ndërsa nxënësi, që e kupton i pari, ngre dorën dhe më pas pëshpërit fjalën për të tjerët.

**Fjalë zinxhir:** Një nxënëse, që mban në dorë një top pëlhure, thotë një emër të përbërë dhe ia hedh topin një nxënësi tjetër, i cili duhet të formojë një fjalë të re, duke përdorur pjesën e

fundit të fjalës së mëparshme. Shembull: *Notebook* → *Bookstore* → *Storefront* → *Frontdoor* → *Doorknob* etj.

**Vendi im në të djathtë është bosh:** Të gjithë nxënësit vendosen në formë rrethi, duke lënë qëllimisht një vend bosh. Nxënësi, që ndodhet në të majtë të vendit bosh, thotë: *My seat on the right is empty, I wish Zana were here!* Zana ngrihet dhe shkon drejt vendit të lirë, duke imituar lëvizjet e një *Zane mali*. Në varësi të moshës së nxënësve, mund të përdoren emra kafshësh apo terma të tjerë, duke kontribuar kështu në zgjerimin e fjalorit receptiv dhe produktiv.

**Vizatim sipas muzikës:** Nxënësit/-et dëgjojnë një pjesë muzikore me sytë mbyllur. Pas dëgjimit, ata i shprehin përshtypjet e tyre përmes vizatimeve. Më pas, zhvillohet një diskutim mbi muzikën dhe mënyrat se si është interpretuar vizualisht ajo përmes vizatimeve të nxënësve.

**Dallimi i zërit me sy të mbyllur:** Një nxënës vendoset në mes të rrethit me sytë e mbyllur. Pasi rrotullohet disa herë, ai ecën në një drejtim të caktuar drejt një bashkëmoshatari. Nxënësi përballë thotë një fjalë të shkurtër, ndërsa nxënësi në qendër duhet ta njohë vetëm nga zëri dhe të thotë emrin e tij.

**Lojë me mikrofon:** Klasa ndahet në dy grupe. Gjysma e nxënësve ulet në rreth dhe diskuton një temë aktuale, ndërsa gjysma tjetër pozicionohet pas karrigeve të shokëve përkatës. Pas çdo deklarate të bërë nga nxënësit që janë ulur, nxënësi pas tij/saj e përsërit fjalinë duke theksuar mesazhin kryesor.

## 5.2 Të folurit

### Shembull për klasën e 6-të

<b>Konteksti tematik:</b> Klasa bën një ekskursion në pyllin afër qytetit. Tema: Kafshët në pyll	
<b>Mësuesja</b>	<b>Nxënësi Klaudio (13 vjeç)</b>
So Klaudio, this morning you had a trip to the forest. Tell me, what did you experience there?	Very good in the forest! I said to Mark: Come on, let's look for lizards. Then he said: Oh yes, good idea. Then we asked Miss, the teacher. She said yes. Then we took a bucket, no, the can, so we can put the lizard inside. Then we were lucky! We saw a lizard. It was hiding under the stone. We found it. It ran away. We tried to catch it. But it went away.
Was it maybe a fire salamander?	Yes, yes. A salam---
You don't see them often in Albania, right?	Ëhë (lëkund kokën). It was beautiful. Nice colors. And it was big. Then we were happy that we found it. Then we went to the others and told everyone what we saw.
<p><b>Vlerësimi i të folurit sipas formularit përkatës:</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b> Përshkrimi i nxënësit paraqitet në mënyrë të qartë dhe të logjikshme. Ai përfshin mendime të rëndësishme që lidhen me përjetimin e tij. Klaudio argumenton mirë përvojën që ka bërë, duke e paraqitur atë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.</p> <p><b>Gjuha:</b> Nxënësi tregon rrjedhshëm dhe në mënyrë koherente. Idetë dhe përshtypjet janë të strukturuar. Fjalori i përdorur është i mjaftueshëm për të përshkruar situatën, megjithëse Klaudio nuk e njuh ende fjalën <i>salamandër</i>. Përveç disa devijimeve të vogla në ndërtimin sintaksor, fjalitë janë kryesisht të sakta, ndonëse të shkurtra. Vërehet një tendencë për të filluar fjalitë me <i>then</i>, e cila mund të pasurohet me alternativa më të larmishme. Klaudio zotëron struktura tregimi që i mundësojnë të shprehë përjetime dhe situata në mënyrë të kuptueshme.</p> <p>Duke u bazuar në këto vlerësime, cilësia gjuhësore e përgjithshme e nxënësit i përgjigjet <b>nivelit 2, B2</b> sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët.</p> <p><b>Nevoja për mbështetje:</b> Nxënësi ka aftësi të shprehur në mënyrë të përshtatshme në dialogë të thjeshtë dhe bashkëbisedime të strukturuar. Për të përmirësuar më tej aftësinë e komunikimit, i nevojiten ushtrime mbështetëse që e ndihmojnë në organizimin e përmbajtjes. Ushtrimet mund të përfshijnë fjalë kyçe, harta mendore apo rrjete konceptesh. Këto teknika do ta ndihmojnë nxënësin t'i shprehë mendimet në mënyrë kompetente, në mënyrë që të tregojë një ngjarje apo përjetim me vijueshmëri të qartë dhe të kontribuojë në mënyrë aktive dhe përshtatshme në biseda.</p>	

### Shembull për klasën e 8-të:

<b>Konteksti tematik:</b> Klasa trajton temën e mjeteve të transportit dhe motorëve të tyre. Në funksion të kësaj teme, mësuesi shpërndan paraprakisht disa figura ilustruese.	
<b>Mësuesi</b>	<b>Nxënësja Ema (15 vjeç)</b>
Ema, can you tell us what is happening in this picture?	The engine works with petrol. To start it needs, emm, how do you say, ... for the engine jump... emm, I don't know in English, in Albanian <i>kandela e makinës</i> . When you turn the key, <i>kandela</i> makes fire. Then the engine works and the car runs.
Right! The spark plug makes a spark! And what happens if it doesn't work?	Yes, the spark plug makes the car run. It also needs petrol. If no petrol inside, if the tank is empty, you have to get petrol and clean. Then the engine works already. You can go to work with the car.
<b>Përmbajtja:</b> Mendimet e shprehura janë të kuptueshme, dhe përmbajtja në përgjithësi është e qartë. Lidhja ndërmjet kandelës dhe benzinës shpjegohet në shumicën e rasteve në mënyrë të qartë. <b>Gjuha:</b> Për shkak të fjalorit të kufizuar dhe mungesës së termave teknike, përdorimi gjuhësor mbetet ende i kufizuar. Ema nuk e njeh ende termin <i>spark plugs</i> dhe ndërron kodin. Ajo përdor fjalë të përgjithshme si <i>works</i> në vend të një termi më të përshtatshëm si <i>starts</i> . Ndërtimi i fjalive bazohet në struktura stereotipe dhe, në disa raste, mbetet i paqartë (p.sh. kuptimi i fjalës <i>clean</i> në kontekstin e përdorur nuk është i qartë). Duke u bazuar në këto vlerësime, aftësia e të folurit së Emës i përgjigjet <b>nivelit 1, A2</b> sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët.  <b>Nevoja për mbështetje:</b> Nxënësës i nevojiten materiale dhe ushtrime mbështetëse për të zhvilluar më tej fjalorin produktiv dhe për të ndërtuar në mënyrë të qëndrueshme aftësitë për të ndërvepruar. Mbështetja duhet të përqendrohet në pasurimin e fjalorit me terma të saktë dhe të përshtatshëm për çdo temë, në përdorimin e drejtë të fjalëve, shprehjeve dhe strukturave gjuhësore në situata të ndryshme komunikimi dhe në përmirësimin e ritmit dhe mënyrës së të folurit, duke e përshtatur me kontekstin. Në afat më të gjatë, rekomandohet që të punohet edhe me aspektet e përmendura më herët në shembullin e Klaudios, për të arritur një kompetencë më të plotë dhe të sigurtë në të folur.	

#### 5.2.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike

- Mësuesit/-et reduktojnë me vetëdije kohën e vet të të folurit gjatë orës së mësimit, duke u krijuar nxënësve mundësi dhe stimuj për të komunikuar dhe për të shprehur aftësitë e tyre gjuhësore në mënyrë të pavarur.
- Ata/ato shmangin ndërhyrjet që mund të ndërpresin rrjedhën e natyrshme të të folurit të nxënësve, duke mos dhënë

komente apo vlerësime të panevojshme si *mirë* ose *po e përsëris, ti the, ...* dhe bëjnë pyetje të mirëfillta ose japin impulse që nxisin mendimin e pavarur dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve në bisedë; i inkurajojnë që të mos japin vetëm përgjigje që dëshiron t'i dëgjojë mësuesi/-ja, por të argumentojnë dhe të diskutojnë në mënyrë të pavarur, me qëllim që të përfitojnë dituri dhe njohuri të reja.

- Duke qenë se në fokus qëndron veprimi komunikues e jo ushtrimi mekanik (drill) apo rregullat gramatikore, mësuesi distancohen nga korrigjimet e panevojshme, si: *Gabim, thuaje saktë!* Ata ofrojnë opsione për formulime që i ndihmojnë nxënësit të mos ndihen të frenuar, por të shprehen natyrshëm dhe në mënyrë autentike.
- Ata janë të vetëdijshëm që nxënësit/-et, sidomos ata me aftësi të kufizuara gjuhësore, përfitojnë nga përsëritjet e qëlluara të mësuesve, duke dëgjuar si tingëllojnë fjalët, të cilat më pas i memorizojnë dhe i përdorin pa ndihmën e dikujt.

Më poshtë vijojnë disa aktivitete praktike që mund të zbatohen në orët e gjuhës angleze:

**Dialogë:** Dialogët me kukulla, meloditë e zërit, të folurit spontan, këngët, vargjet, tregimet, reagimet joverbale si pantomima, mimika apo gjestet ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e artikulimit të mendimeve. Aktivitete të tjera si lojërat me lëvizje ose lojërat auditive nxisin perceptimin. Lojërat dhe ritualet në rreth, kërcimet dhe numërimet apo përmendja e emrave të shoqëruara me duartrokitje, nxisin lëvizjen si një tregues i

rëndësishëm i zhvillimit të përgjithshëm gjuhësor. Vargjet, rimat, tregimet, lojërat me shkronja dhe numra, lojërat e kujtesës, lojërat me role apo me zare, muzika dhe kërcimi e mbështesin zhvillimin e kompetencës së të folurit. Nxënësit/-et përfitojnë nga sekuencat e të folurit, gjatë të cilave ata veprojnë dhe reagojnë spontanisht ose kalojnë nga një rol komunikues në tjetrin.

**Tregimi me litar:** Duke u nisur nga një fotografi, nxënësit/-et krijojnë një tregim në mënyrë spontane. Mësuesi/-ja ndihmon sipas nevojës dhe lidh objekte të ndryshme në një litar që kalon nëpër ambiente të ndryshme të shkollës. Klasa lëviz nga një objekt në tjetrin. Në çdo vend ku ndodhet një objekt, një grup i caktuar nga udhëheqësi i lojës e vazhdon tregimin, duke e përfshirë objektin në të. Në fund, tregimi përsëritet sërish *si në litar*.

**Familja Gjeli:** Një grup nxënësish/-esh ulet në rreth. Mësuesi/-ja ose vetë nxënësit/-et emërtojnë grupin si *Familja Gjeli*, duke përcaktuar role të ndryshme për secilin anëtar: xha Gjeli, qeni i familjes Gjeli, hallat Gjeli, vëllezërit e motrat Gjeli etj. Një nxënëse fillon të tregojë një histori, në të cilën përfshihen sa më shpesh të jetë e mundur emrat e anëtarëve të *familjes Gjeli* (p.sh. një piknik me hallat Gjeli të dielën në Parkun e Liqenit në Tiranë). Sa herë që përmendet një nga anëtarët, personi që përfaqëson atë rol duhet të ngrihet dhe të bëjë një perkulje të lehtë. Kur përmendet e gjithë familja, ngrihen të gjithë pjesëmarrësit njëkohësisht. Nëse një nxënës/-e harron të ngrihet në momentin që përmendet, ai/ajo merr përsipër të vazhdojë tregimin.

**Nxënësja poete:** Të gjithë nxënësit mendojnë një fjalë apo emër të pazakontë. *Nxënësja poete* fillon të tregojë një histori, p.sh. një ngjarje kriminale, një udhëtim imagjinar ose një histori të së ardhmes. Pas disa fjalive hyrëse, ajo tregon me gisht një nxënës tjetër, i cili e thotë fjalën që kisha menduar në fillim. Qëllimi i aktivitetit është që të gjitha fjalët e menduara nga nxënësit të përfshihen në histori njëra pas tjetrës.

**Rolet komunikuese:** Nxënësit/-et hyjnë në role komunikimi përmes situatave reale ose imagjinare. Ky aktivitet nxit të folurit kreativ, p.sh. duke krijuar një tregim nga një ose disa fjalë kyçe, i cili më pas i prezantohet klasës, ose duke përshtatur një tekst si shfaqje teatrore. Gjatë prezantimit të skenave, nxënësit/-et përdorin me vetëdije melodinë e fjalive, theksin, intonacionin, pauzat, ritmin ose zërin.

**Blerje të shpejta:** Një nxënës luan rolin e *tregimtarit* dhe tregon historinë e dy shokëve që shkojnë të blejnë diçka. Nxënësit/et e tjerë luajnë rolet e pronarëve të dyqaneve si *furrë*, *librari* etj. Shokët vizitojnë këto dyqane. Sa herë që *tregimtari* mendon për një dyqan, thotë se shokët duan të blejnë diçka që fillon me një shkronjë të caktuar, të cilën e përmend. Pronarët e dyqaneve duhet të përmendin një artikull që fillon me atë shkronjë dhe që shitet në dyqanin e tyre. Për shembull, nëse përmendet shkronja B, *bakery* [furrë] mund të thotë *bread* [bukë], *bookstore* – *book* [librari – libër] etj. Që të mos zgjatet loja pa fund, *tregimtari* numëron ngadalë deri në dhjetë,

ndërkohë që pronari mendon. Nëse askush nuk përmend ndonjë fjalë, *tregimtari* vendos, nëse do t'i japë edhe një mundësi ndokujt tjetër.

**Milingona bëhet elefant:** Kjo lojë në grupe ose me të gjithë klasën nxit tregimin imagjinar. Një nxënës ka në dorë një objekt dhe, duke bërë gjeste, thotë: *This is an ant, small but hardworking*. Pastaj ia kalon objektin shokut të tij, i cili vazhdon, duke imituar lepurin: *No, this is an Easter Bunny trying to lay eggs*. Loja vazhdon dhe, më në fund, milingona shndërrohet në elefant, duke përmendur secili nxënës një emër kafshe më të madhe se ajo që u përmend paraprakisht.

**Prezantimi treminutësh:** Mësuesi përpilon çdo tre muaj një listë me tema, si p.sh. dëshirë, ëndërr, qëllim, sukses, frikë ose sfidë, të cilën nxënësit/-et e prezantojnë para klasës. Lista varet në mur ose dërrasë, kështu që për çdo ditë tre nxënës/-e shënojnë emrin e tyre dhe temën që duan të prezantojnë të nesërmen. Prezantimi zgjat tre minuta. Pas çdo prezantimi, të tjerët mund t'i bëjnë pyetje grupit prezantues.

**Përshkrimi i imazheve:** Mësuesja ndan klasën në çifte. Secili çift merr imazhe të ngjashme nga ndonjë temë aktuale, por që kanë ndonjë karakteristikë të veçantë. Çdo çift ia përshkruan imazhet që ka zgjedhur çiftit tjetër, por pa ia treguar ato. Për aq kohë sa çifti prezantues i përshkruan imazhet, çifti tjetër dëgjon me vëmendje dhe përpiqet t'i gjejë dallimet që kanë imazhet.

**Tregimi zinxhir:** Një nxënës mban një gurë të vogël në dorë dhe fillon të tregojë një ngjarje. Kur duhet të mendohet, e fërkon gurin dhe ia kalon shokut ose shoqes që ka pranë. Tjetri e merr gurin dhe vazhdon me tregimin. Në fund të tregimit, nxënësit/-et ndahen në çifte, zgjedhin një ide të veçantë nga tregimi, e

zbardhin në letër dhe e prezantojnë para klasës.

**Loja teatrale:** Çdo nxënës/-e zgjedh një objekt (gomë, libër, karrige, laps, fletore etj.) dhe improvizon një *shfaqje teatrale*, duke e prezantuar objektin në mënyrë tërheqëse për publikun. Nuk ka rëndësi, nëse prezantimi përputhet me funksionin real të objektit.

Rëndësi ka që prezantimi të jetë mbresëlënës dhe bindës. Shënim: Paraprakisht duhet të diskutohen rregullat e prezantimit, p.sh. kontakti me sy, retorika, qëndrimi i trupit, karakteristikat e objektit dhe rregullat për komentet e publikut.

### 5.3 Leximi

#### Shembull për klasën e 4-të:

**Konteksti:** Në fillim, nxënësit/-et lexojnë tekstin individualisht. Duke përdorur strategji themelore të leximit dhe me mbështetjen e mësueses, ata aktivizojnë dijet paraprake përmes pyetjes: *Çfarë di unë tashmë për këtë temë?* Në këtë fazë, ata përpiqen të krijojnë lidhje përfytyruese (imazhe mendore), të nxjerrin fjalët kyçe dhe të drejtojnë vëmendjen ndaj përmbajtjes. Në vijim, mësuesja bën pyetje që ndihmojnë fillimisht në vlerësimin e tekstit dhe më pas në nxitjen e aftësisë individuale të leximit të kuptueshëm. Përgjigjet e dy nxënësve të përzgjedhur shërbejnë si ilustrim i qasjes së ndjekur në këtë proces.

#### Jonas

- 1 Jonas rides his bike to the racecourse.
- 2 The meadow with the two goals is located next to the railway.
- 3 There is always someone there to play soccer or handball.
- 4 From a distance, Jonas already sees that Lorik and Martin
- 5 from his class are practicing penalty shots.
- 6 He doesn't know the goalkeeper.
- 7 Jonas parks his bike at the fence and asks if he can join.
- 8 "Sure," says Martin.
- 9 He passes the ball to Jonas. Jonas takes a run-up and aims at the goal.
- 10 A good shot!
- 11 The goalkeeper throws himself at the ball, catches it, and falls into the dirt with it.
- 12 Jonas goes over to him. He wants to know immediately who this super goalkeeper is. He sits on the
- 13 ball and looks at him curiously. Jonas's eyes get wide.
- 14 The goalkeeper is clearly a girl.
- 15 A female goalkeeper!
- 16 She grins at him. "I'm Jana." (teksti: Steinwart 1999, fq. 25f., i përshtatur)

### Përgjigjet e nxënësve:

Legjenda: M = Mësuesja; E = Enri; F = Fabio

#### Shembulli 1: Enri, klasa e 4-të

- M: Where is Jonas going?  
E: *Emm, to the football field?*  
M: Great. And do you also know: Where is the meadow with the two goals?  
E: *Next to the, emm, indoor swimming pool.*  
M: Not the indoor pool, but — it's almost finished. What's the name of the pool that is not inside, the one outdoors?  
E: *Emm, Red field.*  
M: (laughs) Outdoor pool, yes, outdoor pool. That's right.  
M: Is Jonas allowed to play?  
E: *Emm, yes.*  
M: Does Jonas score a goal?  
E: *Emm, yes. No.*  
M: Can you tell how it happens, what he does there? He shoots at the goal — and —  
...  
E: *And, emm, the goalkeeper saves it.*  
M: Right, he catches the ball, even though it was a strong shot.  
M: Tell me: Why is Jonas so surprised when he sees the goalkeeper?  
E: *Because it's a girl.*  
M: Correct! He was really surprised.  
M: What do you think: Who can play soccer better, girls or boys?  
E: (qeshje) *The girls.*

#### Shembulli 2: Fabio, klasa e 4-të

- M: Where is Jonas going?  
F: *To the outdoor pool.*  
M: Are you sure?  
F: *Yes. He rode his bike there.*  
M: And what does he do there?  
F: *Play football. Play handball.*  
M: Does Jonas score a goal?  
F: *Yes.*  
M: Why is Jonas so surprised when he sees the goalkeeper?  
F: (pa përgjigje).

#### Vlerësimi i shembujve sipas formularit përkatës:

**Shembulli 1:** Enri e kupton tekstin mirë dhe pozicionohet midis **niveleve B2** dhe **C1**. Ai i përgjigjet saktë të gjitha pyetjeve të mësueses, madje përgjigjet e tij shkojnë përtej kuptimit fjalë për fjalë. Ai përdor terma dhe koncepte që lidhen me përvojën e tij personale. Për shembull, në pyetjen: *Where is Jonas going?*, ai përgjigjet: *To the football field* në vend të *racecourse*, duke dëshmuar një interpretim të vetin, të arsyetuar.

**Shembulli 2:** Fabio ka vështirësi të theksuara në të kuptuarit e thellë të tekstit dhe ndodhet në **nivelin A1**. Ai mund të kuptojë fjalë të veçuara brenda tekstit, si p.sh. *outdoor pool, football, handball*, por nuk arrin t'i lidhë këto informacione në nivel fjalie. Rrjedhimisht, nuk e kupton zhvillimin e ngjarjeve

dhe mbetet në nivel sipërfaqësor të të kuptuarit. Ai nuk arrin të depërtojë në thellësinë e përmbajtjes së tekstit.

### **Nevoja për mbështetje:**

**Enri:** Megjithëse ky nxënës tregon një nivel të mirë në të kuptuarit e tekstit, ai duhet të mbështetet më tej në pjesën e teksteve informuese dhe letrare, me qëllim që të jetë në gjendje të nxjerrë informacione kyçe, të aktivizojë njohuritë paraprake që ka për lloje të ndryshme tekstesh dhe të ndërtojë pritshmëri gjatë leximit, përmes pyetjeve të veta ose të caktuara nga mësuesja.

Në fushën e leximit të teksteve letrare, ai mund të përkrahet për të kuptuar më thellë zhvillimin e ngjarjeve dhe tiparet e personazheve. Me mbështetjen e mësueses, Enri mund të përfytyrojë ngjarjet, vendet dhe personazhet e tregimeve të shkurtra, të zgjerojë fjalorin receptiv dhe ta lidhë atë me përvojën dhe botën e tij gjuhësore. Rekomandohet që të ushtrojë teknika të leximit, si leximi me zë të qartë, të nxitet për të huazuar libra dhe medie të tjera nga biblioteka e shkollës apo e qytetit, si dhe të angazhohet e motivohet që të lexojë rregullisht.

**Fabio:** Ky nxënës ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme në përvetësimin e aftësive themelore të leximit. Ai duhet të ndihmohet për të njohur menjëherë fjalët e zakonshme dhe për të ndërtuar një fjalor vizual. Duhet të inkurajohet që të lexojë në mënyrë të rrjedhshme tekste tashmë të njohura, të ushtrojë rritjen e vetëbesimit në njohjen e fjalëve të shpeshta dhe të zhvillojë ndjenjën për ritmin gjatë leximit. Tekstet informuese, të shoqëruara me ilustrime dhe detyra që i mundësojnë të theksojnë pjesët kryesore (p.sh., duke i shënuar me ngjyrë), janë premtuese dhe të dobishme. Në një fazë të mëvonshme, synohet që Fabio të përvetësojë gradualisht edhe aftësitë e përshkruara të shembullit të Enrit, duke përparuar drejt një kuptimi më të thellë të teksteve.

### **Shembull për klasën e 7-të**

**Konteksti:** Mësuesi zgjedh qëllimisht një tekst të thjeshtë informues. Fillimisht, ai lexon tekstin me zë dhe kërkon nga nxënësit që të dëgjojnë me vëmendje. Më pas, secilit i shpërndan një kopje të tekstit, të cilin e lexojnë fillimisht në heshtje. Pas leximit individual, nxënësit/-et e diskutojnë tekstin në çifte, e më pas të gjithë së bashku. Në vazhdim, mësuesi i drejton disa pyetje për të nxitur nxënësit që ta përshkruajnë përmbajtjen e tekstit. Si ilustrim, më poshtë jepen përgjigjet e dy nxënësve.

### **Bushball**

Ever heard of Bushball? It's a fun mix between football and golf. The goal is to hit a flag placed in an open area using as few kicks as possible.

The game is played by at least two people. One player sets up the flag, and the others take turns trying to hit it. Each kick is counted, and no player is allowed more than nine shots per turn.

A round ends once every player has had a chance to place the flag. The total number of rounds is up to the players. They decide how long they want the game to last.

### **Përgjigjet e nxënësve:**

*Legjenda: M = Mësuesi; E = Ema; K = Klea*

### **Shembulli 1: Ema, klasa e 7-të**

M: What is the text about?

E: (mbledh supet) *Emm, ball, no, Football... I don't now.*

- M: It's bushball. And what do they count in the game?  
 E: *They shot the ball.*  
 M: And how many shots can one player take?  
 E: *Emm, nine. No, more, ten.*  
 M: What do you have to hit?  
 E: *The player. ... no, the flag.*  
 M: What does a mix between football and golf mean?  
 E: *Emm, is like football, but together, emm (mendohet), I don't know.*  
 M: It's a mix between football and golf.  
 E: *Yes, po (pohon me lëvizje koke).*

### Shembulli 2: Klea, klasa e 7-të

- M: What is the text about?  
 K: *It explains what Bushball is and how the game works.*  
 M: What exactly is counted in the game?  
 K: *The shots, to hit the flag.*  
 M: And how many times can a player shoot?  
 K: *He can shoot nine times per round.*  
 M: What is the goal in Bushball?  
 K: *The flag in the ground.*  
 M: What does a mixture of football and golf mean?  
 K: *Bushball is a game that is played a little like football and a little like golf.*

### Vlerësimi i të lexuarit sipas formularit përkatës:

**Em:** Duke pasur parasysh procesin e trajtimit të tekstit në klasë, nga dialogu rezulton se nxënësja e kupton përmbajtjen në mënyrë të kufizuar dhe ka vështirësi në dhënien e përgjigjeve. Në fakt, ajo identifikon disa fjalë kyçe si *ball, football, flag, nine*, por shfaq pasiguri të theksuara dhe ngatërresa në përgjigje. Fjalori që përdor është fillestar dhe shpesh i pasaktë për kontekstin. Ajo përdor gjuhën e trupit dhe ndërron kodin, duke përdorur fjalën *po* dhe ka vështirësi me strukturën gramatikore. Përgjigjet e Emës pasqyrojnë **nivelin 1 (A1)**.

**Klea:** Nxënësja përmbledh saktë qëllimin e tekstit, duke thënë: *It explains what Bushball is and how the game works*, çka tregon se e kupton përmbajtjen dhe është e aftë ta rindërtojë atë.

Ajo përdor një fjalor të thjeshtë, por të saktë: *The shots to hit the flag*. Zotërimi i strukturës gramatikore dhe ndërtimi frazeologjik janë të dukshëm: *He can shoot nine times per round*. Për objektivin e lojës jep përgjigjen: *The flag in the ground*, duke dalluar saktë qëllimin e fundit të lojës. Kur e pyet mësuesi se çfarë do të thotë fraza *a mix between football and golf*, Klea shpjegon në mënyrë të kuptueshme: *Bushball is a game that is played a little like football and a little like golf*. Këto përgjigje të nxënësës përkojnë me **nivelin 2 (B1)**.

### Nevoja për mbështetje:

**Em:** Kjo nxënëse ka nevojë për mbështetje në zgjerimin e fjalorit përmes ushtrimeve, në mënyrë që të kalojë nga niveli 1 (A1-A2) në nivelin 2 (B1-B2). Ushtrimet e ndihmojnë që të ndërtojë fjali të plota dhe t'i përvetësojë njohuritë gramatikore, si në aspektin fonologjik, ashtu edhe në atë morfologjik dhe sintaksor. Mësuesit/-et i ofrojnë nxënësës mjete vizuale dhe ushtrime për përparimin e aftësive komunikuese, me qëllim që të kuptojë më saktë përmbajtjen e teksteve me gojë dhe me shkrim dhe t'i shprehë mendimet e saj në mënyrë të kuptueshme, duke përdorur fjalë që kërkon konteksti dhe ta zotërojë

strukturën gramatikore. Për këtë, rekomandohen lojëra si *word bingo*, fjalë të vizualizuara përmes ilustrimeve dhe aktivitete të tjera që ofrojnë ky manual dhe tekstet mësimore të gjuhës angleze. Duke dëgjuar sekuenca auditive në mënyrë të përsëritur dhe duke u përfshirë në biseda dyshe apo në grup, inkurajohet t'i përvetësojë aftësitë e saj receptive dhe produktive. Të shkruarit në mënyrë të rregullt dhe rishikimi i përmbajtjes së tyre, përdorimi i vetëdijshëm i formulimeve alternative dhe i mjeteve vizuale premtojnë gjithashtu progres gjuhësor.

**Klea:** Për këtë nxënëse rekomandohet zgjerimi i fjalorit në *gjuhën e edukimit*, duke punuar me sinonime, antonime, shprehje idiomatike dhe frazeologji për të pasuruar të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Përmes ushtrimeve, ajo inkurajohet të argumentojë në mënyrë bindëse (aftësi pragmatike dhe diskursive) dhe të formulojë e organizojë mendimet në mënyrë koherente. Ballafaqimi aktiv me strukturën gramatikore, si p.sh. ndërtimi i fjalive të përbëra, ushtrimi i kohëve dhe gjinive gramatikore, formulimi i fjalive në formën pasive dhe aktive, përfshirë këtu edhe të folurit spontan dhe reagimin e saktë ndaj pyetjeve, janë gjithashtu elemente të rëndësishme për të përparuar vetëbesimin, të menduarit kritik dhe aftësitë gjuhësore.

Qëllimi është thellimi i kompetencës gjuhësore dhe arritja e nivelit gjuhësor 3 (C1).

### 5.3.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike

Sipas modeleve aktuale, procesi i të lexuarit zhvillohet: a) në kontekstin social që përfshin ndikimin e familjes, shkollës, bashkëmoshatarëve dhe përvojat e përbashkëta kulturore, b) në nivelin personal që lidhet me vetëdijen dhe vetëvlerësimin e nxënësit (p.sh. njohuritë, përfshirja aktive, motivimi dhe reflektimi mbi procesin e leximit) dhe c) në nivelin e procesit të leximit që ka të bëjë me trajtimin e tekstit, duke përfshirë njohjen e fjalëve, fjalive dhe strukturës së përgjithshme të

tekstit. Për nxitjen e nxënësve që të lexojnë në mënyrë efikase gjatë orëve të mësimt, rekomandohen biseda të hapura rreth teksteve, leximi përmes udhëzimeve të mësuesve dhe strukturimi i leximit në hapa të kuptueshëm për moshën e nxënësve. Kështu nxënësit/-et aftësohen t'i kuptojnë fjalët dhe fjalitë, të përdorin strategji të përshtatshme, të lexojnë rrjedhshëm dhe të ndihen të sigurt gjatë leximit të një teksti. Thënë kjo, në vazhdim vijojnë disa ide praktike:

**Leximi hap pas hapi:** Mësuesit/-et dhe nxënësit zgjedhin së bashku një tekst që duan ta lexojnë pjesë-pjesë. Një nxënës lexon deri sa të ndodhë një ndërprerje e zakonshme, ku të tjerët bëjnë ndonjë pyetje. Sekuenca e lexuar mund të përmbajë disa fjali, një paragraf ose një strofë (në poezi). Pastaj vazhdon të lexojë një nxënës tjetër. Te kjo mënyrë nuk pritet një paraqitje e plotë e leximit. Qëllimi është që nxënësit t'i kuptojnë fjalët përmes përsëritjes, pyetjeve inkurajuese dhe vetëkorrigjimit.

lexon me intonacion të theksuar e të saktë. Ajo e përjeton të lexuarit si një lloj tregimi me fjalët e një personi tjetër. Te kjo metodë nuk lejohen ndërhyrjet apo korrigjimet nga të tjerët. Për këtë mënyrë leximi preferohen tekste të shkurtra.

**Leximi me zë:** Vetëm nxënësja që lexon e ka tekstin përpara, kurse të tjerët ende nuk e njohin tekstin dhe varen nga mënyra si ajo lexon. Nxënësja që lexon përgatitet paraprakisht dhe

**Leximi në formë loje:** Në këtë formë ushtrimi të leximit me zë, nxënësit/-et rikthehen te tekstet që i kanë lexuar në heshtje apo me zë, duke u mbështetur në dialogë dhe duke i paraqitur ato përmes lojërave të shkurtra improvizuese. Këto sekuenca leximi me karakter improvizues reduktojnë pasigurinë dhe krijojnë një atmosferë më të relaksuar në klasë.

**Leximi i heshtur:** Kalimi nga leximi me zë të ulët tek ai në heshtje kërkon një hyrje paraprake, sepse përfshin përballje të pavarur me tekstin. Tekstet duhet të përputhen me aftësitë leksikore, semantike, gramatikore dhe letrare të nxënësve. Një diskutim paraprak, fjalorët, leximi në çift, udhëzimet e qarta nga ana e mësuesve ose versionet e ndryshme të të njëjtit tregim janë disa nga mënyrat që e lehtësojnë leximin në heshtje. Gjatë leximit të tekstit në heshtje, nxënësit e analizojnë titullin, karakteret e personazheve, nënvizojnë emrat, mbiemrat dhe fjalët kyçe me laps me ngjyrë, shpjegojnë fjalët përmes fjalorit etj.

**Leximi krahasues:** Mësuesi/-ja vë në dispozicion disa tekste mbi të njëjtën temë (p.sh. poezi për botën e kafshëve). Nxënësit/-et identifikojnë zhanrin e tekstit (poezi, prozë, komik, rrëfim me figura). Më pas, i udhëzon nxënësit/-et që ta përcaktojnë llojin e tekstit, p.sh. nëse kemi të bëjmë me poezi, prozë, tekst informues, tregim me figura etj. Në hapin tjetër, nxënësit/-et i krahasojnë tekstet në mënyrë kritike, duke analizuar se si paraqitet i njëjti fenomen në forma të ndryshme. Në sekuencën e radhës lexojnë me vëmendje dhe evidentojnë ndryshimet midis dy teksteve pothuajse identike. Në përfundim, një nxënës merr tekstin e plotë si pikënisje për një ushtrim me fjalë kyçe dhe i drejtohet shoqes të bankës, e cila ka të njëjtin tekst, por me fjalët kryesore të shlyera:

*Si mund t'i plotësosh vendet bosh në tekstin tënd? Më pas e krahasojnë versionin e plotësuar me origjinalin. Shënim: Tekstet me vende bosh, siç janë, fjale bie, C-testet – të tillë gjenden shumë në materialet mësimore – janë sfidues, sepse kërkojnë aftësi të larta gjuhësore.*

**Leximi krijues:** Kjo metodë ka për qëllim përfshirjen aktive gjatë ballafaqimit me tekstin. Përtej kuptimit të përmbajtjes, kjo qasje ndërthur leximin me shkrimin, të folurit dhe shprehjen personale, duke shndërruar tekstin në një hapësirë për eksplorim dhe interpretim të lirë. Nxënësit/-et vazhdojnë një rrëfim të filluar, japin konkluzione alternative, krijojnë situata të

reja përmes fjalëve kyçe, përdorin një gjuhë që duhet ta deshifrojnë shokët e klasës etj. Leximi krijues nxit nxënësit/-et të ndryshojnë këndvështrimin, duke rrëfyer ngjarjet nga perspektiva e një personazhi dytësor, të shkruajnë poezi apo tregime të reja nisur nga një informacion i shkurtër, apo të krijojnë një *histori të kundërt* që sfidon rrjedhën origjinale të ngjarjeve. Po ashtu, ata mund të ndërhyjnë në strukturën e tekstit, duke hequr ose shtuar interpretime individuale.

**Leximi interpretues:** Nxënësit/-et interpretojnë tekstet letrare:


- duke i zbuluar veçoritë gjuhësore të autorit ose autores dhe duke menduar si do të shpreheshin vetë;
- duke i nënvizuar fjalët më të rëndësishme në një poezi;
- duke i krahasuar disa poezi nga këndvështrime të ndryshme, si atmosfera, ngjyrat artistike, dinamika e veprimit, humori, tingujt dhe ritmi.
- duke i paraqitur ato grafikisht përmes vizatimeve;

Ky lloj leximi nxit jo vetëm të kuptuarit estetik dhe kritik, por edhe përvojën personale me tekstet letrare.

**Ditari i leximit:** Është një mjet për vëzhgimin e procesit të leximit dhe ndihmon nxënësit/-et që të përballen me tekstet dhe të kuptojnë përmbajtjen e tyre. Ditari mund të përdoret si gjatë orës së mësimi, ashtu edhe jashtë saj dhe mund të menaxhohet në mënyrë individuale përmes pyetjeve të hapura ose sipas udhëzimeve të strukturuar më parë. Në rastin e detyrave, që lidhen me leximin e librave, duhet të merren parasysh interesat individuale të nxënësve. Shënim: Në klasat ku nxënësit/-et nuk kanë përvojë me ditarë leximi, rekomandohet një fillim i strukturuar që shmang mbingarkesën. Me kalimin e kohës, ata mund të zgjedhin vetë një libër që dëshirojnë ta lexojnë, duke shtuar informacionet më të rëndësishme në ditarin personal, nëse posedojnë një të tillë.


## 5.4 Shkrimi

### Shembull për klasën e 3-të:

<b>Detyrë</b>	Krijim rreth temës <i>Unë dhe sporti im i preferuar</i>
<b>Niveli 2 (B1):</b>	<p>Teksti origjinal:</p>  <p><b>Vlerësim i përgjithshëm: Niveli 2, B1</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b> Teksti është në përputhje me temën e dhënë dhe fokusohet qartësisht te futbolla. Renditja e mendimeve ndjek një rrjedhë kronologjike dhe kuptohet lehtë.</p> <p><b>Gjuha:</b> Në përgjithësi ka një rrjedhë logjike të mendimit, ku pikëpamja subjektive shprehet në mënyrë të kuptueshme. Në tekst mbizotërojnë fjalitë e pavarura. Katër fjalitë e para fillojnë me përemrin <i>I</i>, në vetën e parë njëjës, gjë që tregon një ndërtim të njëtrajtshëm që mund të zhvillohet më tej. Lidhëzat si <i>and</i> janë të pranishme, por përdorimi i tyre mund të bëhet më i natyrshëm dhe më i larmishëm. Vërehen përpjekje për ndërtimin e fjalive të përbëra. Pikëpamja personale është e dallueshme.</p> <p><b>Fjalori:</b> Fjalët janë të pranishme për kontekstin dhe tregojnë një përpjekje për të shmangur përsëritjet. Megjithatë, fjalori mbetet i thjeshtë dhe me pak larmi. Teksti është shumë i shkurtër, edhe pse nxënësi ka pasur kohë të mjaftueshme për të shkruar një tekst më të gjatë.</p> <p><b>Gramatika dhe drejtshkrimi:</b> Përdorimi i kohës së tashme është i saktë dhe i qëndrueshëm (p.sh. <i>am, end, going</i>). Foljet dhe fjalët funksionale janë zgjedhurar dhe lakuar siç duhet. Pikësimi është kryesisht i saktë, me përjashtim të mungesës së pikës në fund të fjalisë së fundit. Drejtshkrimi është korrekt përgjatë gjithë tekstit.</p> <p><b>Nevoja për mbështetje:</b></p> <p>Nxënësi ka nevojë për mbështetje në drejtim të zgjerimit të fjalorit, në përputhje me moshën dhe nivelin e tij gjuhësor, si dhe për përvetësimin e strategjive bazë të shkruarit.</p> <p>Për nxënësin rekomandohen sekuenca të shkurtra shkrimi, si p.sh. përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve të preferuara, ndërtimi i fjalive të thjeshta dhe të njohura, letra personale me përshëndetje dhe urime për ditëlindje, ditarë të shkurtër mësimorë, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta si përpilimi i një reviste shkollore, postera etj. Këto aktivitete do ta ndihmojnë të shkruajë më rrjedhshëm (si me dorë, ashtu edhe me</p>

	<p>tastierë), duke zhvilluar fjalorin produktiv dhe ndërtimin e fjalive, si dhe duke ndërtuar një bazë solide për procese më të përparuara të të shkruarit. Me ushtrime të vazhdueshme, Marloni mund të mësojë të përdorë në mënyrë të qëllimshme strukturën, përmbajtjen, gjuhën dhe formën në përputhje me llojin dhe qëllimin e tekstit. Ai, gjithashtu, duhet të inkurajohet të gjenerojë ide për të shkruar, t'i organizojë dhe strukturojë ato dhe të planifikojë procesin e të shkruarit (p.sh. përmes skicave, hartave mendore, listave me fjalë kyçe etj.), qoftë në mënyrë individuale, qoftë në bashkëpunim me të tjerët.</p>
--	--

### Shembull për klasën e 6-të:

<b>Detyrë</b>	Krijim rreth temës <i>Familja ime</i>
<b>Niveli 2-3 (B2-C1)</b>	<p>Teksti original:</p>  <p><u>My family</u> I have a beautiful and a lovely family. It includes five people: my mom, my brother, my grandma, my grandpa and me. We all live in a house which is in a village. We all like to go out in the weekends but we don't go in restaurants, we visit our country. We have a family business. Sometimes I talk to customers in our shop when they speak english. I have went to an english course since 6 years old. I really like the english language but I prefer more to talk with a british accent. Till now my learnings are great I enrolled the 6th grade and I'm going to the 7th grade. I am so excited to learn new things. In the future I would like to study medicine or computer engineering but I haven't decided yet. In my free time even when I'm on vacations I like to read books. I'm like I want to be a mom's princess because it isn't possible to be a dad's princess because he isn't alive. I am a happy kid and I live in a happy family. With respect Kler.</p> <p><b>Vlerësim i përgjithshëm: Niveli 2-3, B2-C1</b>  <b>Përmbajtja:</b> Teksti lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me temën dhe dëshmon për njohuri të kënaqshme faktike nga ana e nxënësës.  <b>Gjuha:</b> Nga fjala deri te struktura e fjalisë dhe ndërtimi i tekstit në tërësi, vërehet qartësisht pavarësia dhe vetëkontrolli në shprehje. Teksti është i kuptueshëm, i organizuar mirë dhe koherent. Nxënësja e trajton temën në një kontekst të gjerë, me një gjuhë të pasur dhe të diferencuar. Qëndrimi i saj është i qartë, argumentet janë lehtësisht të identifikueshme.  <b>Fjalori:</b> Klera zotëron një fjalor të pasur dhe të larmishëm, të cilin e përdor me saktësi dhe efikasitet. Ajo kombinon në mënyrë të qëndrueshme kategori të ndryshme fjalësh (emra, folje, mbiemra etj.), duke dëshmuar</p>

	<p>aftësi të zhvilluara në përdorimin e tyre; si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor.</p> <p><b>Gramatika dhe drejtshkrimi:</b> Përdorimi i fjalëve funksionale dhe përmbajtësore është i saktë dhe i qëndrueshëm. Nxënësja përdor me kompetencë struktura të ndryshme sintaksore, si fjali të thjeshta, ashtu edhe të përbëra. Megjithëse në tekst mbizotërojnë fjalitë që fillojnë me vetën e parë njëjës, rrëfimi është megjithatë i larmishëm dhe i kontrolluar. Drejtshkrimin dhe shenjat e pikësimit i përdor saktë.</p> <p><b>Nevoja për mbështetje:</b> Në parim, nxënësja nuk ka nevojë për ndonjë mbështetje të veçantë. Niveli i saj në të shkruar është i lartë dhe i përshtatshëm për moshën. Ajo duhet të inkurajohet të zhvillojë më tej aftësitë e saj në <i>gjuhën akademike</i> (të ashtuquajturat aftësi CALP – cognitive academic language proficiency), sidomos në aspektin leksikor-semantik, morfosintaksor, pragmatik-diskursiv dhe letrar. Rekomandohet që të vazhdojë të shkruajë rregullisht në zhanre të ndryshme, si p.sh. vjersha, përmbledhje, emaile, postera, kontribute për revistën e shkollës, slajde për prezantime, postime në blog apo ditarë mësuesorë.</p> <p>Këto aktivitete e ndihmojnë të forcojë aftësitë krijuese me shkrim, të organizojë edhe më mirë mendimet, idetë dhe përfytyrimet – qofshin ato reale apo imagjinare – dhe t'i shprehë ato në mënyrë të qartë dhe të qëllimshme, në përputhje me atë që synon të arrijë nëpërmjet tekstit të shkruar.</p>
--	--

#### 5.4.1 Rekomandime didaktike dhe ide praktike

- Mësuesit/-et kanë në dispozicion një gamë të gjerë mundësish didaktike për planifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve me shkrim. Ata organizojnë sekuenca pune në grupe të vogla, me gjysmën ose me të gjithë klasën, duke marrë parasysh natyrën heterogjene gjuhësore të nxënësve. Nëse është e nevojshme, ofrojnë detyra të përshtatura sipas nevojave individuale të nxënësve. Mësuesit/-et:
  - përzgjedhin përmbajtjen përmes së cilës synohet arritja e objektivave të të nxënësve;
  - zgjedhin tema që stimulojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe që i ndihmojnë ata të thellojnë njohuritë e tyre;
  - përcaktojnë strategjitë që duhet të zotërojnë nxënësit/-et gjatë procesit të të shkruarit, redaktimit dhe prezantimit të teksteve në mënyrë kompetente;
- përzgjedhin përmbajtje të mirëstrukturuara dhe me qasje ndërdisiplinore, të cilat ndjekin një logjikë të brendshme koherente;
- sigurohen që objektivat janë të qarta dhe të realizueshme;
- krijojnë kushte që procesi i të shkruarit të mundësojë zhvillimin e ideve, rishikimin, përmirësimin dhe ruajtjen e përmbajtjes, duke mbështetur njëkohësisht edhe transferimin e dijes;
- përcaktojnë kriteret e qarta vlerësimi për tekstet e nxënësve, duke u siguruar që lloji i tekstit të përputhet me standardet përkatëse dhe me udhëzimet e dhëna;
- hartojnë detyra që janë motivuese, të mbështetura në pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve, duke pasur njëkohësisht parasysh edhe fushat në të cilat kanë nevojë për progres;
- marrin parasysh vështirësitë drejtshkrimore që shfaqen në tekstet e shkruara të nxënësve dhe krijojnë hapësirë për ushtrime të përshtatura për klasën (këto ushtrime i

integrojnë, për shembull, gjatë trajtimit të një teksti të leximit ose i deklarojnë qartë si sekuenca trajnimi);

- heqin dorë nga tekstet artificiale, të ndërtuara vetëm mbi një dukuri të caktuar ortografike dhe që nuk ofrojnë përmbajtje

domethënëse dhe, në vend të tyre, ushtrojnë me nxënësit/-et rregullisht drejtshkrimin e fjalëve që i përdorin shpesh e të cilat njëkohësisht shërbejnë edhe për zgjerimin e fjalorit.

## **Ide praktike për klasat 2 – 4:**

**Restoranti im i preferuar:** Nxënësit/-et hartojnë një menu për restorantin e tyre të preferuar (p.sh. në lagjen e tyre ose në një destinacion pushimi në Shqipëri. Ata përfshijnë ushqimet që pëlqejnë më shumë dhe ndërtojnë skena loje të frymëzuara nga përvoja e tyre. Skenat stimulojnë situata reale restoranti, duke përdorur sende të zakonshme të klasës si zëvendësim për enët e gatimit. Më pas, nxënësit/-et lexojnë menutë dhe luajnë skenat para klasës.

**Çfarë di unë:** Nxënësit/-et shkruajnë dhe ilustrojnë tema sipas interesit, si p.sh. emra zogjsh, kërpudhash, marka makinash apo dije të veçanta personale. Janë të mirëpritura edhe fjalë ose fraza të imagjinuara, me karakter krijues, si në shembullin: *SMALL-LAID CAT'S EGG, ONE METER TALL.*

**Të shkruarit përmes fjalëve nxitëse:** Përmes një loje me zar ose përzgjedhjes nga *kutia e fjalëve*, nxënësit/-et zgjedhin 3 – 4 fjalë dhe shkruajnë një tregim imagjinar. Kush dëshiron, e lexon tregimin para klasës.

**Përjetimi im i veçantë:** Nxënësit/-et përshkruajnë lirshëm një përjetim të veçantë, për shembull pas një vizite në fermë, në kopshtin zoologjik, në muze apo në cirk. Mund të shkruajnë gjithashtu për përjetime personale si humbja e një kafshe shtëpiake, një aksident në plazh, vizitë në spital etj.

**Ku banoj:** Nxënësit/-et vizatojnë një pamje të shtëpisë së tyre ose një *plan* të thjeshtë të lagjes ku jetojnë. Aty mund të shtojnë emra familjesh, emra rrugësh, tabela rrugore e të tjera elemente përshkruese.

## **Ide për klasat 5 – 9:**

**Fjalë trokitëse (knock words):** Nxënësit/-et ulen në grupe prej 5 – 10 vetash, secili me një fletë të formatit A4 përpara. Loja fillon me një

**Macja magjike:** Fillimisht, një nxënëse ose mësuesi lexon një tregim të shkurtër si ky: *Magic Cat – My cat is enchanted, I know that for sure. In reality, she is a magical lady. If she wanted, she could slip through the wide chimney and ride on a broomstick like a witch in the sky. She could do many other things, too, if only she wanted – she would know exactly what to do. But it doesn't even cross her mind. Why? Because she wants to be my cat – and that's just fine!* Nxënësit/-et krijojnë një tregim të ngjashëm me një kafshë tjetër, p.sh.: *My dog is enchanted, that is perfectly clear to me. In reality, his name is Mr. Wonderful...*

**Apel:** Nxënësit/-et shkruajnë një fletushkë ose poster me një mesazh apelues, si p.sh: *Eat healthily! Sleep enough! Take care of your body! Don't throw rubbish on the ground!* Ata gjithashtu mund të shkruajnë tekste reklamuese për sporte, produkte imagjinare apo oferta humoristike.

**Një tregim për ditarin tim:** Nxënësit/-et shkruajnë tekste reflektuese në ditarin e tyre, duke përdorur formulime të paracaktuara për fjali, si: *When I am at my favorite place, I write about.... To be able to write a good story, this is how I proceed:...*

nxënës që luan rolin e *trokitësit*: Ai troket në dysHEME dhe, në atë çast, të gjithë të tjerët regjistrojnë fjalën e parë që u vjen ndërmend. Më pas, secili ia dikton fjalën e tij/saj *trokitësit*,

i cili i shkruan në një fletë. Roli i *trokitësit* kalon te një tjetër dhe procesi përsëritet derisa të gjithë të kenë marrë pjesë. Në fund, çdo nxënës/-e ka një listë prej pesë deri në dhjetë fjalësh, të cilat duhet t'i përdorë për të shkruar një tekst brenda një minutazhi të caktuar.

**Të shkruarit me imazhe:** Nxënësve u jepen 3 – 5 imazhe (p.sh. piktura nga një muze arti), prej të cilave zgjedhin një. Më pas, kryejnë një nga një aktivitete krijuese: Imagjinojnë veten brenda imazhit dhe përshkruajnë përjetimin; supozojnë sikur janë artisti/-ja dhe tregojnë çfarë kanë ndjerë apo menduar gjatë krijimit, rrëfejnë se çfarë ndodh më pas në skenën e paraqitur.

**Përshkrimi:** Përshkrimet, me gojë apo me shkrim, fokusohen në pamjen e jashtme të objekteve të perceptueshme, si ndërtesa,

**Rondeli:** Një poezi me tetë rreshta, ku rreshtat 1, 4 dhe 7 janë të njëjtë. Rreshtat 2 dhe 8 janë gjithashtu të njëjtë. Udhëzime: **1.** Write a sentence that you like best. Use it to begin your rondel (a type of poem), and also write this line again in lines 4 and 7. **2.** Read the first line again. What comes to your mind when you read it? Now write down your thoughts related to line 1 – this will be line 2 of your rondel. Also use this line as line 8. **3.** Now complete the remaining lines – 3, 5, and 6 – with more thoughts and ideas. Për lehtësi, rekomandohet që rreshtat e njëjtë të dallohen me shenja grafike.

**Kutia e yjeve:** Fillimisht lexohen horoskopët e ditës dhe diskutohen shkurtimisht. Më pas, nxënësit/-et analizojnë tekstin: cilat janë fjalët tipike, figurat gjuhësore etj. Secilit i jepet një letër në të cilën vizaton simbolin e shenjës së vet astrologjike. Letrat palosen dhe vendosen në kutinë e yjeve. Çdo nxënës/-e zgjedh një letër tjetër nga kutia (jo të vetën) dhe shkruan një horoskop të ri për atë shenjë, të cilin më pas e vendos sërish në kuti. Horoskopët lexohen në mënyrë anonime. Në fund diskutojnë së bashku: *Do you believe it? Who writes these texts in the newspaper? Why do people read them?*

peizazhe, imazhe, bimë etj. Mund të përshkruhen objekte të pranishme ose që mungojnë (p.sh. biçikletë e vjedhur, pamja nga banesa në qytet). Qëllimi është t'i ofrohet lexuesit/-es një ide e qartë vizuale. Shembuj objektesh: pëllumbat që fluturojnë rreth e rrotull pallatit, dhoma e ngrohjes, një qendër tregtare, godina e shkollës, veshja e një personi apo një peizazh.

**Poezia me të gjitha shqisat:** Zgjidhet një ndjenjë si titull i poezisë. Ajo shkruhet bukur dhe dekorohet. Pastaj krijohen figura gjuhësore ose krahasime për secilën shqisë: pamja, tingulli, aroma, shija dhe prekja. Shembull: *Loneliness looks like a kitten on the highway – Loneliness sounds like an echo that no one hears.* Rreshti përmbyllës, i ndërtuar me *like*, duhet të përmbledhë thelbin e ndjesisë.

**Zgjerimi i një tregimi:** Mësuesja lexon fillimin intrigues të një tregimi, si: *A woman loudly tries to sell a 1,000-note for 980.00 Lek in front of the post office in Durrës. The note is real. Passersby avoid the woman. Fifteen minutes later, she has to answer very difficult questions at the Durrës police station.* Nxënësit/-et duhet të krijojnë një tregim bindës që shpjegon këtë situatë.

**Kurthet logjike:** Bazuar në një tekst të dhënë nga mësuesi, nxënësit/-et shkruajnë tregime që përmbajnë *kurthe logjike*. Shembull: *A plane crashed exactly on the border between Russia and China. A dispute then broke out between the two countries about which country should bury the survivors.*

**Shkrimi automatik:** Mësuesja jep një fjalë, fjali ose pyetje nxitëse. Nxënësit fillojnë të shkruajnë menjëherë dhe pa ndërprerje për një kohë të caktuar, duke ndjekur rrjedhën e lirë të mendimeve. Nëse bllokohen, thjesht përsërisin fjalën e fundit, derisa të rifillojë rrjedha. Gabimet gramatikore dhe fjalitë e papërfunduara janë të lejueshme. Ky aktivitet ka për qëllim lehtësimin e procesit të shkruarit dhe kapërcimin e bllokimeve krijuese.

**Aroma e kujtimeve:** Materialet e nevojshme për këtë aktivitet përfshijnë enë të vogla me aroma të ndryshme: sapun, limon, kanellë, portokall, trumzë, trëndafil, kafe etj. Nxënësit/-et, me sytë mbyllur, nuhasin një aromë dhe imagjinojnë një kujtim apo ndjenjë që lidhet me të. Kur u shfaqet një skenë në mendje, hapin sytë dhe fillojnë të shkruajnë.

#### **Shënim:**

Seria *Material për mësimin e gjuhës së prejardhjes* (<https://myheritagelanguage.com/>) ofron shembuj konkret për mësimin e gjuhëve.

## **6. Udhëzime për përdorimin e formularëve**

### **6.1 Formulari Përshkrimi i praktikës gjuhësore**

Formulari Përshkrimi i praktikës gjuhësore ka në qendër motivimin e nxënësve për të mësuar gjuhët dhe ndriçon perspektivën e tyre individuale. Ai pasqyron praktikat gjuhësore të nxënësve, brenda dhe jashtë mjedisit shkollor. Përmes një bisede të shkurtër dyshe, mësuesi/-ja kupton më shumë rreth preferencave gjuhësore (në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e huaja) të nxënësve dhe merr informacion për praktikat e tyre mediatike, si p.sh. a shikojnë filma apo programe, a dëgjojnë radio, sa shpesh e bëjnë këtë, në cilët gjuhë etj. Kjo i mundëson mësuesit/-es të krijojë një panoramë të përgjithshme, duke filluar nga praktika e **të dëgjuarit**, dhe të përdorë të dhënat për të përpiluar një plan të personalizuar mbështetjeje. Se informacionet e nxënësit/-es pasqyrojnë më shumë dëshira sesa realitet, mësuesi/-ja mund ta kuptojë këtë përmes pyetjeve konkrete, si për shembull: *Për çfarë bëhej fjalë në dramën e fundit që dëgjuve?* Në lidhje me **të folurit**, mësuesi/-ja zbulon nëse dhe sa shpesh nxënësi/-ja komunikon në kohën e lirë, në cilat gjuhë dhe përmes cilave mënyra (telefon, whatsapp, rrjete sociale). Në **lexim** mësuesi/-ja vlerëson nëse nxënësi/-ja lexon me zë apo në heshtje, në gjuhën amtare apo në gjuhë të huaja, sa shpesh lexon në kohën e lirë dhe çfarë tekstesh preferon. E njëjta gjë vlen për **shkrimin**, ku nxënësi/-ja tregon sa shpesh shkruan në kohën e lirë, çfarë e motivon, nëse shkruan me iniciativë

vetjake, çfarë tekstesh preferon të shkruajë dhe cilat mjete përdor për të shkruar.

Në lidhje me **aspektet e tjera**, po ashtu të rëndësishme, mësuesi/-ja mund të mësojë gjithashtu nëse nxënësi/-ja përdor strategji të përshtatshme kur përballet me vështirësi gjatë komunikimit me gojë ose me shkrim. Mësuesi/-ja merr informacion mbi interesin e nxënësit/-es për gjuhët dhe motivimin për t'i mësuar ato, si dhe ndihmën që i ofrohet gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë, qoftë në shkollë, qoftë në familje.

Ky formular mund të përdoret pa asnjë kufizim në lidhje me nivelin e njohurive të gjuhës angleze dhe është i përshtatshëm për t'u aplikuar në periudha të ndryshme të procesit mësimor, përfshirë edhe fazën fillestare të të nxënësve të një gjuhe të huaj në shkollë. Të dhënat e mbledhura gjatë bisedës me nxënësin/-en shërbejnë si element i hartimit të një plani individual mbështetës. Ky proces i paraprin vlerësimit më të detajuar të aftësive gjuhësore të nxënësit/-es, i cili realizohet përmes përdorimit të formularëve specifikë për dëgjimin, të folurit, leximin dhe shkrimin.

### **6.2 Formularët: Dëgjimi, Të folurit, Leximi, Shkrimi**

Përshkrimet e niveleve, të vendosura në krye të secilit formular vlerësimi, informojnë mbi aftësitë në një fushë të caktuar të gjuhës. Indikatorët në anën e majtë të secilit formular (përmbajta, gjuha, fjalori, gramatika), të cilët lidhen me aspekte specifike të kompetencës gjuhësore, mundësojnë një vlerësim më të detajuar dhe ofrojnë udhëzime për planifikimin e mbështetjes individuale.

Në mes të formularit shënohen pikët e arritura që tregojnë në cilat aspekte të fushës gjuhësore nxënësi/-ja ka pika të forta dhe ku paraqiten vështirësi. Këto të dhëna, së bashku me shënimet që pasqyrohen në anën e djathtë të formularit, ndihmojnë gjithashtu në planifikimin e masave mbështetëse që i përshtaten situatës gjuhësore të nxënësit/-es. Formulimet e pasqyruara në secilin formular shërbejnë si orientim, duke pasur parasysh që

zhvillimi i aftësive gjuhësore është një proces individual dhe dinamik, i cili ndodh me ritme të ndryshme. Me progresin gjuhësor, diferencat mes nxënësve mund të bëhen më të theksuara. Prandaj, për planifikimin e mbështetjes individuale nuk është vendimtar vetëm niveli aktual gjuhësor, por veçanërisht përparimi i dukshëm midis dy momenteve të vlerësimit, p.sh. brenda një periudhë tre ose gjashtëmuajore. Rastet kur nxënësit/-et shënojnë progres minimal, ndër të tjera, sinjalizojnë mungesën e përdorimit të strategjive të përshtatshme për të përmirësuar aftësitë gjuhësore. Në këto raste, mësuesit e përfshirë mbështesin nxënësin/-en që të përdorë strategjitë e duhura që e ndihmojnë të mësojë gjuhën në mënyrë efikase.

Vlerësimi i aftësive gjuhësore me anë të formularëve të Albatest-it ka kuptim vetëm për

nxënësit/-et që tashmë kanë krijuar një bazë të qëndrueshme të fjalorit dhe njohurive gjuhësore. Për nxënësit/-et që kanë kufizime leksikore apo gjuhësore, rekomandohet një periudhë përgatitore prej 3 – 4 muajsh, gjatë së cilës ata mund të mësojnë rreth 200 fjalë bazë. Vetëm pas kësaj periudhe kohore ka kuptim vlerësimi i strukturuar i nivelit gjuhësor përmes formularëve. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, vëzhgimet dhe bisedat paraprake me nxënësin/-en, planifikohen dhe zbatohen masat përkatëse të mbështetjes.

Formularët e vlerësimit mund të përdoren në mënyrë të kombinuar ose të pavarur. Për shembull, nëse një nxënës/-se ka nevojë specifike për mbështetje në të dëgjuar, mund të përdoret vetëm formulari për vlerësimin e kësaj fushe gjuhësore.

# SHTOJCA

## Formulari PËRSHKRIMI I PRAKTIKËS GJUHËSORE

Emri:

Mbiemri:

Data:

**Shënim:** Ky formular plotësohet nga personat përgjegjës gjatë bisedës me nxënësin/-en.

### DËGJIMI

<i>Shënim: Aspektet në vijim bazohen në pohimet e nxënësit/-es.</i>	Shqip				anglisht			
	çdo ditë	1 herë në javë	më shumë se 1 herë në javë	rrallë	çdo ditë	1 herë në javë	më shumë se 1 herë në javë	rrallë
Dëgjon tekste auditive, p.sh. tregime, drama	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shikon filma, diskutime dhe programe televizive, në youtube	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Shënim: Aspektet më poshtë i referohen gjuhës angleze dhe paraqesin vëzhgimet e mësuesit/-es.</i>					-	o	+	
Merr pjesë në biseda dyshe ose në grup	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ndjek mësimin përmes dëgjimit të teksteve dhe udhëzimeve me gojë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Kupton në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar atë që dëgjon	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përzgjedh, organizon dhe integron mirë informacionin që dëgjon gjatë mësimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komente shtesë: Vlerësim për praktikën e të dëgjuarit:								

### TË FOLURIT

<i>Shënim: Aspektet në vijim bazohen në pohimet e nxënësit/-es.</i>	Shqip				anglisht			
	çdo ditë	një herë në javë	më shumë se 1 herë në javë	rrallë	çdo ditë	një herë në javë	më shumë se 1 herë në javë	rrallë
Komunikon në kohën e lirë (në shtëpi, me shoqërinë)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikon gjatë pushimit (të shkurtër/gjatë) në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Shënim: Aspektet më poshtë i referohen gjuhës angleze dhe paraqesin vëzhgimet e mësuesit/-es.</i>					-	o	+	
Merr pjesë aktive në biseda gjatë mësimit me gojë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Flet shumë, edhe nëse mund të bëjë gabime	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përfshihet në diskutime për tema mësimore vetëm kur ndihet i/e sigurt	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Flet pak kur trajtohen tema të ndryshme në orët mësimore								
Komente shtesë: Vlerësim për praktikën e të folurit:								
<b>LEXIMI</b>								
<i>Shënim: Aspektet në vijim bazohen në pohimet e nxënësit/-es.</i>	<b>Shqip</b>				<b>anglisht</b>			
	çdo ditë	1 herë në javë	më shumë se 1 herë në javë	rrallë	çdo ditë	1 herë në javë	më shumë se 1 herë në javë	rrallë
Në familje ekziston një traditë e të lexuarit nga anëtarët e saj	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Lexon në kohën e lirë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Huazon libra nga biblioteka, mësuesit/-et, shokët/shoqet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit i blejnë libra, revista, comics	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Shënim: Aspektet më poshtë i referohen gjuhës angleze dhe paraqesin vëzhgimet e mësuesit/-es.</i>						–	○	+
Lexon me dëshirë në mjedisin shkollor								
Lexon rrjedhshëm								
Ndan me të tjerët (nxënës ose mësues) përmbajtjen e asaj që ka lexuar.								
Komente shtesë: Vlerësim për praktikën e të lexuarit:								
<b>SHKRIMI</b>								
<i>Shënim: Aspektet në vijim bazohen në pohimet e nxënësit/-es.</i>	<b>shqip</b>				<b>anglisht</b>			
	çdo ditë	1 herë në javë	më shumë se njëherë në javë	rrallë	çdo ditë	1 herë në javë	më shumë se 1 herë në javë	rrallë
Shkruan gjatë kohës së lirë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shkruan për veten (ditar)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shkruan për të tjerët (tekste të shkurtra, poezi, tekste informuese, letra)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Shënim: Aspektet më poshtë i referohen gjuhës angleze dhe paraqesin vëzhgimet e mësuesit/-es.</i>						–	○	+
Merr iniciativën për të shkruar gjatë procesit mësimor								
Shkruan tekste të llojeve të ndryshme								

Komente shtesë: Vlerësim për praktikën e të shkruarit:

### ASPEKTE TË TJERA

	Shqip			anglisht			
<i>Shënim: Aspektet në vijim bazohen në pohimet e nxënësit/-es.</i>	shpesh	nganjëherë	rrallë		shpesh	nganjëherë	rrallë
Kërkon ndihmë kur nuk kupton ose ka vështirësi për t'u shprehur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pranon ndihmën në shkollë kur ka nevojë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
I ofrohet ndihmë në shtëpi kur ka nevojë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Merr pjesë në jetën shoqërore jashtë shkollës: në familje, me shoqërinë, në grupe sportive, muzikore etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Shënim: Aspektet më poshtë i referohen gjuhës angleze dhe paraqesin vëzhgimet e mësuesit/-es.</i>					-	o	+
Vlerësim për kompetencat sociale: krijon dhe mirëmban kontaktet me bashkëmoshatarët, tregon respekt dhe e pranon atë, është tolerant, përkujdeset, tregon ndjeshmëri							
Di të kontrollojë emocionet dhe të rregullojë afërsinë dhe distancën							
Di të përballet me kritikën dhe të kritikojë në mënyrë konstruktive							
Komente shtesë: Vlerësim për kompetencat ndërdisiplinore (sociale, ndërkulturore, etj.):							

**Emri:****Mbiemri:****Data:****Formulari DËGJIMI****Shpërndarja e pikëve:** përmbajtja 5; gjuha 3; fjalori 2**Maksimumi:** 10 pikë*Shënim:* Kriteret e vlerësimit më poshtë duhet të kenë parasysh moshën e nxënësve dhe planin mësimor shqiptar.**Përshkrimi i niveleve:****Niveli 1, A1-2:** Nxënësit janë në gjendje të kuptojnë pjesërisht atë që dëgjojnë dhe varen ndjeshëm nga ndihma e mësuesit/-es. Për shkak të fjalorit tepër të kufizuar dhe mungesës së strategjive të dëgjimit, ata kanë aftësi të kufizuar receptive.**Niveli 2, B1-2:** Nxënësit janë të aftë të kuptojnë përmbajtje që lidhen me jetën e përditshme dhe me shkollën, si nga tregimet gojore të bashkëmoshatarëve dhe të mësuesve, ashtu edhe nga tekstet për dëgjim. Ata zotërojnë një fjalor të qëndrueshëm dhe përdorin strategji efektive dëgjimi. Megjithatë, në rastet kur përballen me tema të ndërlikuara ose me përmbajtje me shumë terma teknikë, kanë ende nevojë për shpjegime nga mësuesi/-ja.**Niveli 3, C1-2:** Nxënësit zotërojnë aftësi të përparuar dëgjimi dhe janë në gjendje të kuptojnë saktësisht dhe në mënyrë të kontekstualizuar përmbajtje gojore më të gjata dhe komplekse nga fusha dhe zhanre të ndryshme (si poezi, tregime, tekste shkencore, dokumentarë etj.). Ata përdorin me zotësi strategjitë e përqendrimit dhe i kushtojnë vëmendje elementeve joverbale, si intonacioni, toni i zërit dhe ritmi i të folurit.

Përshkrimi i përmbajtjes	Niveli			Pikët	Masat e nevojshme përkrasë (Testuesi/-ja shënon në kolonën bosh më poshtë masat mbështetëse që rezultojnë nga vlerësimi me këtë formular.)
	1 (A1 -2)	2 (B1 -2)	3 (C1 -2)		
<b>Përmbajtja:</b> Nxënësi/-ja...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- kupton në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar përmbajtjen dhe fjalorin e tekstit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- kupton (mes rreshtave) se çfarë thonë dhe mendojnë të tjerët me atë që shprehin përmes monologëve dhe dialogëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- kupton tregimet, udhëzimet dhe informacionet në mënyrë të lidhur dhe të pavarur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		

- kupton dhe është i aftë të përpunojë përmbajtjen faktike të asaj që dëgjon, si në aspektin tematik, ashtu edhe në atë leksikor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- reagon me vizatime apo ilustrime ndaj mesazheve të thjeshta dhe të ndërlikuara që dëgjon	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Përshkrimi gjuhësor</b>				
<b>Gjuha:</b>				
- merr pjesë në mënyrë të përshtatshme në çift dhe në diskutime mësimore me të gjithë klasën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- reagon në mënyrë adekuate ndaj sinjaleve joverbale në situata dëgjimore me folës të dukshëm ( <i>shqiptim, ritëm, intonacion, qëndrim i trupit, gjeste, mimikë</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Fjalori:</b>				
- kupton në mënyrë të pavarur fjalë që përdoren në biseda të përditshme dhe tema specifike që trajtohen gjatë mësimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- kupton me kompetencë llojet e fjalëve, familjeve të fjalëve, sinonimeve, antonimeve, homonimeve, metaforave, shprehjeve idiomatike, frazeologjive	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Totali i pikëve:</b>				
<b>Nota:</b> <sup>1</sup> <b>10</b> = 9-10 pikë; <b>9</b> = 8-9 pikë [niveli 3, C1-C2]; <b>8</b> = 7-8 pikë; <b>7</b> = 6-7 pikë [niveli 2, B1-B2]; <b>6</b> = 6 pikë; <b>5</b> = 5 ose më pak pikë [niveli 1, A1-A2]				

<sup>1</sup> Notat janë në përputhje me sistemin shqiptar të vlerësimit; 10 është nota më e lartë dhe 5 më e ulët. Rezultati sipas pikëve të arritura ka karakter formues dhe shërben vetëm si orientim, jo si vlerësim përmbljedhës që arsyeton notën në dëftesë.

**Emri:****Mbiemri:****Data:****Formulari TË FOLURIT****Shpërndarja e pikëve:** përmbajtja 3; gjuha 3; fjalori 2; gramatika 2**Maksimumi:** 10 pikë*Shënim:* Kriteret e vlerësimit të mëposhtëm duhet të kenë parasysh moshën e nxënësve dhe planin mësimor shqiptar.**Përshkrimi i niveleve:**

**Niveli 1, A1-2:** Nxënësit/-et janë në gjendje të shprehen ose të prezantojnë tema apo biseda vetëm pjesërisht. Të folurit e tyre shpesh kërkon pyetje sqaruese dhe interpretim nga dëgjuesi/-ja. Për shkak të kufizimeve leksikore dhe mungesës së strategjive të të folurit, ata përdorin mjetet verbale dhe joverbale në mënyrë të kufizuar dhe varen në masë të theksuar nga ndihma e mësuesve.

**Niveli 2, B1-2:** Nxënësit/-et artikulojnë në mënyrë të pavarur përmbajtjet e teksteve letrare ose informuese dhe përdorin me kompetencë mjete joverbale, si gjestet apo mimikën. Gjatë prezantimeve ose tregimeve, ata përdorin një fjalor të pasur dhe të larmishëm. Megjithatë, ende mbështeten në struktura të njohura gjuhësore. Teknikat e të folurit i përdorin në mënyrë të duhur, por shqiptimi i tyre nuk është gjithmonë i qartë dhe, në disa raste, kërkon pyetje apo ndërhyrje sqaruese.

**Niveli 3, C1-2:** Nxënësit/-et zotërojnë aftësi të përparuara të të folurit dhe janë në gjendje të paraqesin përmbajtje të zgjeruara dhe në përputhje me moshën e tyre. Dëgjuesit janë në gjendje t'i ndjekin lehtësisht në aspektin gjuhësor dhe përmbajtësor. Ata kombinojnë në mënyrë efikase elementet verbale dhe joverbale, përdorin fjalor të saktë e të avancuar dhe kanë një shqiptim të qartë dhe të natyrshëm.

**Përshkrimi i përmbajtjes**

	Niveli			Pikët	Masat e nevojshme përkrahëse  (Testuesi/-ja shënon në kolonën bosh më poshtë masat mbështetëse që rezultojnë nga vlerësimi me këtë formular.)
	1 (A1-2)	2 (B1-2)	3 (C1-2)		
<b>Përmbajtja:</b> Nxënësi/-ja...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- prezanton saktë dhe kuptueshëm përmbajtjen e një teme apo qëndrimet, situatat dhe mendimet që shpreh me gojë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- shpreh mendime të rëndësishme rreth temës së caktuar nga mësuesi/-ja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- paraqet argumentet në mënyrë bindëse; reagon në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me kontekstin në diskutime rreth temave të ndryshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		

- shpreh një larmi idesh ( <i>me pro dhe kundër, zgjidhje personale, emocionuese, bindëse</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- ndjek koherencën përmbajtësore ( <i>përsëritje, logjikë, strukturim mendimesh</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Përshkrimi gjuhësor</b>				
<b>Gjuha:</b>				
- ndjek një rrjedhë logjike gjatë artikulimit të mendimeve dhe qëndrimeve ( <i>mbështjellje e qartë e ideve, formulim i saktë i fjalëve dhe fjalive, p.sh. house, flower, table, book; At home I have flowers and books on the table</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- i përmbahet koherencës gjuhësore ( <i>renditje e kuptueshme, strukturim, formulim adekuat dhe kuptimplotë</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- përdor një stil gjuhësor që përputhet me moshën ( <i>i paanshëm, i kuptueshëm, i qartë në strukturë, interesant</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- përdor në mënyrë të përshtatshme teknikat dhe pajisjet e komunikimit, qoftë me prezencë fizike, qoftë online ( <i>në biseda në grup, në prezantime me gojë</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Fjalori:</b>				
- përdor një gamë të gjerë dhe larmi fjalësh në mënyrë të pavarur dhe të diferencuar ( <i>fjalë të përditshme dhe të veçanta, përdorim i saktë i llojeve të ndryshme të fjalëve, fjalive</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- zgjedh në mënyrë të përshtatshme dhe të saktë fjalët dhe fjalorin ( <i>në përputhje me përmbajtjen dhe kontekstin</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- përdor teknika të përshtatshme gjatë të folurit ( <i>shqiptim, ritëm, rrjedhë e të folurit, intonacion, qëndrim i trupit, gjeste, mimikë, kontrollim i zërit</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- ndërton fjalët dhe fjalitë sipas llojit të tekstit apo të temës ( <i>sinonime, antonime, metafora, shprehje idiomatike, frazeologjike</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- zgjeron fjalorin në mënyrë të përshtatur për moshën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Përshkrimi i normës gjuhësore</b>				
<b>Gramatika:</b>				
- shpreh format e fjalëve sipas rregullave gramatikore ( <i>fjalë funksionale, gjinia dhe rasa, zgjedhim dhe lakim i pjesëve të ligjëratës</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- ndërton fjalitë saktë dhe gramatikisht të kombinuara ( <i>fjali e varur, e pavarur, e thjeshtë, e përbërë</i> )				
<b>Totali i pikëve:</b>				

<b>Nota:</b> <sup>2</sup> <b>10</b> = 9-10 pikë; <b>9</b> = 8-9 pikë [niveli 3, C1-C2]; <b>8</b> = 7-8 pikë; <b>7</b> = 6-7 pikë [niveli 2, B1-B2]; <b>6</b> = 6 Pt.; <b>5</b> = 5 më pak pikë [niveli 1, A1-A2]		
--	--	--

<b>Emri:</b>	<b>Mbiemri:</b>	<b>Data:</b>
--------------	-----------------	--------------

**Formulari LEXIMI**  
**Shpërndarja e pikëve:** përmbajtja 3; gjuha 3; fjalori 2; gramatika 2  
**Maksimumi:** 10 pikë  
*Shënim:* Kriteret e vlerësimit të mëposhtëm duhet të kenë parasysh moshën e nxënësve dhe planin mësimor shqiptar.

**Përshkrimi i niveleve:**

**Niveli 1, A1-2:** Nxënësit/-et nxjerrin informacione të veçuara në nivel fjale, por nuk arrijnë t'i paraqesin ato në mënyrë të lidhur apo të kuptojnë strukturën e përgjithshme të tekstit. Informacionet që lexojnë mbeten të fragmentuara dhe të izoluara nga njëra-tjetra.

**Niveli 2, B1-2:** Nxënësit/-et e kuptojnë përmbajtjen në nivel fjalie dhe i lidhin ato me njëra-tjetrën. Ata arrijnë të kuptojnë rendin logjik të veprimeve dhe të ndjekin një rrëfim apo shpjegim në mënyrë të vazhdueshme.

**Niveli 3, C1-2:** Nxënësit/-et kuptojnë përmes kontekstit përmbajtje të nënkuptuara në tekst dhe nxjerrin përfundime. Ata e kuptojnë tekstin si një tërësi dhe vërejnë informacionet dhe nuancat, duke përdorur njohuritë e tyre gjuhësore, tematike, kulturore dhe përvojën personale.

Përshkrimi i përmbajtjes	Niveli			Pikët	Masat e nevojshme përkrahëse  (Testuesi/-ja shënon në kolonën bosh më poshtë masat mbështetëse që rezultojnë nga vlerësimi me këtë formular.)
	1 (A1-2)	2 (B1-2)	3 (C1-2)		
<b>Të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit:</b> Nxënësi/-ja...					
- kupton fjalët kyçe të tekstit të leximit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- identifikon automatikisht strukturat e shkronjave dhe rrokjeve gjatë leximit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- kupton kontekstin e një pjese ose të gjithë tekstit që lexon	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- kujdeset për koherencën tematike dhe përmbajtësore ( <i>p.sh. tregime me figura, tekste informuese, poezi, tregime</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		

<sup>2</sup> Notat janë në përputhje me sistemin shqiptar të vlerësimit; 10 është nota më e lartë dhe 5 më e ulët. Rezultati sipas pikëve të arritura ka karakter formues dhe shërben vetëm si orientim, jo si vlerësim përmbljedhës që arsyeton notën në dëftesë.

Përshkrimi gjuhësor				
<b>Gjuha:</b>				
- njeh në mënyrë të saktë raportin mes shkronjave dhe tingujve, si dhe të strukturave të fjalëve apo fjalive	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- identifikon dhe prezanton saktë dhe në mënyrë të diferencuar llojet e teksteve ( <i>prozë, poezi, tregime, tekste informues</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- përshtat gjuhën në raport me tekstin që lexon ( <i>lexim me zë, ritëm, intonacion</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Fjalori:</b>				
- kupton në mënyrë receptive tekstet me përmbajtje të ndryshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- njeh kuptimin dhe funksionin e llojeve të fjalëve në tekst, p.sh. të sinonimeve, antonimeve, metaforave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- kupton larminë e llojeve të fjalëve që përmban teksti i leximit ( <i>emra, mbiemra, folje, ndajfolje, parafralë</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- ndërton fjalët në përputhje me temën ( <i>terma teknike, sinonime, antonime, metafora</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Përshkrimi i normës gjuhësore				
<b>Gramatika, drejtshkrimi, shenjat e pikësimit:</b>				
- identifikon saktë format e fjalëve në tekst ( <i>fjalë funksionale, gjini dhe rasë, fjalë të lakuara, përemra</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- kupton ndërtimin e fjalive: fjali e pavarur, e varur, e thjeshtë, e përbërë, lidhëzat, nyjat, lakimin dhe zgjedhimin e pjesëve të ligjëratës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- identifikon me kompetencë drejtshkrimin gjatë leximit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- njeh në mënyrë automatike shenjat e pikësimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Totali i pikëve:</b>				
<b>Nota:</b> <sup>3</sup> <b>10</b> = 9-10 pikë; <b>9</b> = 8-9 pikë [niveli 3, C1-C2]; <b>8</b> = 7-8 pikë; <b>7</b> = 6-7 pikë [niveli 2, B1-B2]; <b>6</b> = 6 pikë; <b>5</b> = 5 ose më pak pikë [niveli 1, A1-A2]				

<sup>3</sup> Notat janë në përputhje me sistemin shqiptar të vlerësimit; 10 është nota më e lartë dhe 5 më e ulët. Rezultati sipas pikëve të arritura ka karakter formues dhe shërben vetëm si orientim, jo si vlerësim përmblendës që arsyeton notën në dëftesë.

**Emri:****Mbiemri:****Data:****Formulari SHKRIMI****Shpërndarja e pikëve:** përmbajtja 3; gjuha 3; fjalori 2; gramatika 2**Maksimumi:** 10 pikë*Shënim:* Kriteret e vlerësimit të mëposhtëm duhet të kenë parasysh moshën e nxënësve dhe planin mësimor shqiptar.**Përshkrimi i niveleve:**

**Niveli 1, A1-2:** Nxënësit/-et arrijnë të identifikojnë informacione të përgjithshme, por i paraqesin ato në formë të shkruar me shumë pak koherencë. Të dhënat ngelin të izoluara dhe pjesërisht të paqarta. Tekstet e tyre shfaqin mungesë vetëdijeje dhe pavarësie në strukturim dhe formulim, si dhe shpesh përmbajnë riprodhim të drejtpërdrejtë të pjesëve nga teksti i dhënë nga mësuesi/-ja.

**Niveli 2, B1-2:** Nxënësit/-et kuptojnë përmbajtjen e një pjese të tekstit dhe i lidhin fjalitë në mënyrë që të krijojnë një rrjedhë të kuptueshme të ngjarjeve. Njohuritë e tyre gjuhësore dhe tematike janë pjesërisht të dukshme. Megjithatë, ata vazhdojnë të mbështeten ndjeshëm të tekstit i dhënë, gjë që kufizon pavarësinë dhe aftësinë për një përpunim të thelluar. Si pasojë, tekstet e tyre shfaqin aftësi mesatare në formulim, strukturim dhe përdorimin e strategjive.

**Niveli 3, C1-2:** Nxënësit/-et nxjerrin me arsyetim të qartë përmbajtje të nënkuptuara nga konteksti dhe formulojnë përfundime të sakta. Ata kuptojnë qëllimin dhe mesazhin e përgjithshëm të tekstit, si dhe janë në gjendje të dallojnë informacione të nënkuptuara. Për këtë, ata përdorin në mënyrë të vetëdijshme njohuritë e tyre gjuhësore, tematike dhe teknike. Falë këtij integrimi, ata e përpunojnë përmbajtjen dhe prodhojnë tekste me nivel të lartë në formulim, strukturim dhe përdorim të strategjive të të shkruarit.

Përshkrimi i përmbajtjes	Niveli			Pikët	Masat e nevojshme përkrahëse  (Testuesi/-ja shënon në kolonën bosh më poshtë masat mbështetëse që rezultojnë nga vlerësimi me këtë formular.)
	1 (A1-2)	2 (B1-2)	3 (C1-2)		
<b>Përmbajtja:</b> Nxënësi/-ja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- ka qasje individuale të pavarur ndaj temës ( <i>qëndrim objektiv</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
- formulon mendime të rëndësishme mbi temën e caktuar nga mësuesi/-ja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		

- shprehet përmes teksteve që shkruan në mënyrë të diferencuar dhe përdor argumente të arsyetuara	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- shfaq larmi idesh gjatë të shkruarit ( <i>pro dhe kundër, zgjidhje kreative, përmbajtje emocionuese, përdorim teknikash</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- shpreh mendimet rrjedhshëm dhe me lidhje përmbajtësose ( <i>përsëritje, logjikë, strukturim</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Përshkrimi gjuhësor</b>				
<b>Gjuha:</b>				
- ndjek rrjedhën kuptimore ( <i>lidhje e qartë mes pjesëve të tekstit</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- i përmbahet koherencës gjuhësore ( <i>renditje e kuptueshme, strukturim</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- zotëron një stil të përparuar gjuhësor ( <i>i qartë, i qëndrueshëm, i larmishëm, i rëndësishëm</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Fjalori:</b>				
- zotëron një fjalor të pasur dhe të pavarur ( <i>jo i bazuar vetëm në tekstin e paracaktuar</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- përzgjedh saktë dhe në mënyrë të përshtatshme fjalët ( <i>në përputhje me përmbajtjen dhe kontekstin</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- përdor një mori dhe larmi të llojeve të ndryshme të fjalëve ( <i>emra, mbiemra, folje, ndajfolje, parafjalë</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- ndërton fjalët dhe fjalitë larmishëm dhe në përputhje me kontekstin ( <i>terma teknikë, sinonime, antonime, metafora</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Përshkrimi i normës gjuhësore</b>				
<b>Gramatika, drejtshkrimi, shenjat e pikësimit:</b>				
- përdor saktë dhe sipas rregullave gramatikore fjalët dhe fjalitë ( <i>fjalë funksionale, gjinia dhe rasa, zgjedhimi dhe lakimi i pjesëve të ligjëratës</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- ndërton fjali në ndryshme në përputhje me rregullat sintaksore ( <i>ato fillojnë me lloje të ndryshme fjalësh, kombinim mes fjalisë së pavarur dhe të varur, fjali të thjeshta, të përbëra, lidhëza, nyje</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
- zbaton saktë rregullat e drejtshkrimit dhe shenjat e pikësimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<b>Totali i pikëve:</b>				
<b>Nota:</b> <sup>4</sup> <b>10</b> = 9-10 pikë; <b>9</b> = 8-9 pikë [niveli 3, C1-C2]; <b>8</b> = 7-8 pikë; <b>7</b> = 6-7 pikë [niveli 2, B1-B2]; <b>6</b> = 6 pikë; <b>5</b> = 5 ose më pak pikë [niveli 1, A1-A2]				

<sup>4</sup> Notat janë në përputhje me sistemin shqiptar të vlerësimit: 10 është nota më e lartë dhe 6 më e ulët. Rezultati sipas pikëve të arritura ka karakter formues dhe shërben vetëm si orientim, jo si vlerësim përmbljedhës që arsyeton notën në dëftesë.



## 7. Shpjegim termash

Më poshtë janë përmbledhur dhe shpjeguar me shembuj termat kryesorë të këtij manuali. Përzgjedhja nuk pretendon të jetë e plotë. Shpjegimet i referohen gjithmonë kontekstit specifik të Albatest-it. Si referencë shërben *Enciklopedia e gjuhësisë* e autores Hadumod Bussmann (2008).

**Chunk:** Është një grup fjalësh që përdoren shpesh së bashku dhe kanë kuptim të plotë. Nxënësit nuk duhet t'i ndërtojnë fjalët një nga një; e përdorin si një pjesë të gatshme. *Shembull:* I don't know; at the end of the day; by the way.

**Fjala funksionale:** Një klasë fjalësh me funksion kryesisht gramatikor, format e të cilave ndryshojnë pak. *Shembull:* nyjat (the, a), lidhëzat (and, because), parafjalët (in, on, under).

**Fjala kyçe:** Fjalë ose shprehje karakteristike që identifikon përmbajtjen ose veprimet qendrore të një teksti. *Shembull:* Në një tekst për ndryshimet klimatike, fjalët kyçe mund të jenë: global warming, emissions, sustainability.

**Fjala e përbërë:** Një fjalë e formuar nga dy ose më shumë fjalë (p.sh. çelësi i derës, fusha e futbollit). Ka shumë kombinime të ndryshme: emër + emër, mbiemër + emër, folje + emër, etj. *Shembull:* fusha e futbollit, luledielli, ha bukë.

**Fjalori produktiv (aktiv):** Fjalori që një folës e përdor vazhdimisht kur flet dhe shkruan. *Shembull:* Nxënësi shkruan: I need a pencil.

**Fjalori receptiv (pasiv):** Përfshin fjalët që kuptohen, por nuk përdoren në mënyrë aktive. *Shembull:* Nxënësi kupton 'to admire', por nuk e përdor vetë.

**Fonologjia (teoria e tingujve):** Merret me tingujt e të folurit dhe shenjat e shkruara. Mbështet përdorimin e diferencuar të tingujve. *Shembull:* Gjuha shqipe ka dy tinguj të ndryshëm /r/: uvular/e butë dhe alveolar/e dridhur [rr].

**Formimi i fjalëve:** Procesi i krijimit të fjalëve të reja përmes kompozimit ose derivimit. *Shembuj:*

- Kompozim: book + page = book page; sun + flower = sunflower
- Derivim: satisfied → satisfaction (prapashtesë), dissatisfied (parashtesë); teach → teacher; happy → unhappy.

**Gramatika:** Studimi i rregullave sipas të cilave formohen dhe kombinohen fjalët në fjali. Përshkruan strukturat morfologjike dhe sintaksore të një gjuhe. *Shembull:* Saktë: She walks to school. Pasaktë: She walk to school.

**Gjuha e edukimit / akademike:** Përfshin regjistra gjuhësorë dhe kulturorë që shkojnë përtej përdorimit të përditshëm të gjuhës. Kombinon aftësi gjuhësore dhe ndërdisiplinore të nevojshme për pjesëmarrje në diskursin arsimor dhe akademik. Nxënësit/-et duhet të aftësohen të përmbledhin, diskutojnë, reflektojnë dhe të mendojnë në mënyrë kritike mbi përmbajtjen. *Shembull:* Rezultatet sugjerojnë se ndryshimet klimatike po përshpejtohen (në vend të: Po bëhet më nxehtë).

**Gjuha e parë (L1):** Gjuha që mësohet më së pari, zakonisht ajo që përdoret më shpesh. Nuk duhet domosdoshmërisht të jetë ‘gjuha e parë’ në kuptim biografik: nëse një gjuhë e dytë bëhet dominuese, p.sh. pas moshës parashkollore, ajo mund të kthehet me kohë në gjuhën e parë. Termi është pra fleksibël dhe relativ. *Shembull:* Një fëmijë rritet duke dëgjuar greqisht në shtëpi, mëson shqip në kopsht, dhe më vonë shqipja bëhet gjuha e tij dominuese L1.

**Gjuha e përditshme:** I referohet gjuhës jo të standardizuar që përdoret në jetën e përditshme, shpesh me ndikime dialektore dhe që mund të devijojë nga norma. *Shembull:* ‘gonna’ në vend të ‘going to’.

**Gjuha e shkollës:** Gjuha që përdoret në klasë, e ndikuar nga kërkesat didaktike. *Shembull:* Eksperimenti tregon se lëngjet zgjerohen kur nxehen.

**Harta mendore (Mind map):** Një hartë kujtese që strukturon të menduarit dhe planifikimin vizualisht dhe gjuhësisht. Nëntemat ose imazhet dalin nga një koncept qendror. E përshtatshme për brainstorming ose planifikim mësimesh. *Shembull:* Fjala qendrore ‘Stinët’ → pranverë, verë, vjeshtë, dimër.

**Hartë konceptesh (Concept map):** Është një paraqitje vizuale e dijes që tregon konceptet dhe lidhjet midis tyre. Konceptet vendosen zakonisht në rrethe dhe lidhen me linja, duke e bërë përmbajtjen më të qartë, të kuptueshme dhe më të lehtë për t’u mësuar. *Shembull:* Nga koncepti ‘Koha e foljeve’ dalin ‘e tashmja, e shkuara, e ardhmja’, secila e vizualizuar me shembuj si: *I eat* dhe *I will eat*.

**Loja e të mësuarit të gjuhës:** Është një formë mësimi që nxit përdorimin aktiv të fjalëve përmes lojërave. Nuk duhet përdorur si kompensim për plotësimin e minutazhit të orës mësimore, por posaçërisht për të ushtruar dhe

**Kognicioni:** Term i përgjithshëm për proceset mendore si perceptimi, njohja, imagjinata, të menduarit ose planifikimi. Është baza për të mësuarit e vetëdijshëm dhe për transferimin e njohurive. *Shembull:* Të kujtuarit e një liste blerjesh ose planifikimi për zgjidhjen e një problemi matematikor.

**Kompetencat:** Janë aftësi kognitive, motivuese dhe sociale që mund të mësohen dhe që i mundësojnë nxënësit/-et të zgjidhin probleme në situata të ndryshme me sukses dhe përgjegjësi. *Shembull:* Nxënësit gjatë punës në çift zhvillojnë një dialog në anglisht, zgjedhin fjalët e duhura, zbatojnë saktë strukturat gramatikore dhe e mbështesin njëri-tjetrit gjatë ushtrimeve.

**Leksiku:** Fjalori i një gjuhe ose varieteti gjuhësor, i renditur sipas kriterëve alfabetike ose tematike. Në këtë manual, leksiku i referohet nivelit që trajton kuptimin e fjalëve individuale. *Shembull:* Leksiku i anglishtes përmban fjalë si *house, happiness, run*.

**Leksiku mendor:** Pjesë e kujtesës afatgjatë ku fjalët ruhen sipas parimeve të tyre organizative (p.sh. të kundërtat, ngjashmëritë). Përfaqëson të gjithë fjalorin individual. *Shembull:* Nxënësi kujton fjalën ‘hot’ dhe e lidh mendërisht me ‘cold’ (e kundërta).

**Lista semantike e fjalëve:** Koleksion fjalësh, kuptimi i të cilave mund të deduktohet nga konteksti dhe praktikohen në thënie dhe kontekste kuptimplota. *Shembull:* Frutat: mollë, banane, dardhë, mango.

konsoliduar fjalët në kontekst. *Shembull:* Loja ‘memory’ me çifte figurë–fjalë (dog–qen, cat–mace).

**Lloji i tekstit (zhanri):** Një grup tekstesh me karakteristika të përbashkëta. *Shembull:* fabul, poezi, tregim, raport shkencor, e-mail.

**Metagjuha: Gjuha për gjuhën:** Është reflektim i vetëdijshëm ose intuitiv mbi strukturat dhe shprehjet gjuhësore (vetëdija gjuhësore). *Shembull:* ‘Quickly’ është ndajfolje sepse përshkruan si kryhet veprimi.

**Morfologjia (formimi i fjalës):** Pjesë e gramatikës që përshkruan strukturën dhe ndryshimin e fjalëve (p.sh. zgjedhimi i foljeve, rasat e emrave, shkallëzimi i mbiemrave). *Shembull:* run → runs → running; happy → happier → happiest.

**Ndërkulturor:** I referohet marrëdhënieve midis kulturave. Në kontekstin shkollor, kjo nënkupton të kuptuarit e domethënies tipike kulturore të fjalëve. Përveç gjuhës, edhe gjestet, shprehjet e fytyrës dhe format e tjera të shprehjes luajnë rol. Dallimet kulturore janë një pasuri, por gjithashtu mbartin potencial konflikti, prandaj është e rëndësishme të trajtohen me vetëdije në klasë. *Shembull:* Në Japoni përshëndetja bëhet me përkulje, kurse në Shqipëri tipike është shtrëngimi i dorës.

**Ndërveprimi:** Ndikimi i ndërsjellë mes individëve apo grupeve (p.sh. fëmijë–mësues,

**Sintaksa (struktura e fjalisë):** Pjesë e gramatikës që përshkruan strukturën e fjalive. *Shembull:* ‘Fëmijët luajnë’ është fjali e thjeshtë me subjekt dhe kallëzues.

**Shumëgjuhësia:** Aftësia për të shprehur veten në disa gjuhë. Nuk nënkupton domosdoshmërisht zotërimin e barabartë të të gjitha gjuhëve; përfshihet edhe kuptimi receptiv (pasiv). *Shembull:* Një person flet turqisht në shtëpi, shqip në shkollë dhe anglisht me gjyshen në Amerikë.

fëmijë–fëmijë) dhe mes gjuhëve në situata kontakti. *Shembull:* Mësuesi pyet: Çfarë mendon ti? → Nxënësi përgjigjet dhe mësuesi e ndërton më tej bisedën.

**Pjesët e ligjëratës (kategori leksikore):** Kategori gramatikore që klasifikon fjalët sipas formës dhe kuptimit të tyre (p.sh. emra, folje, mbiemra, ndajfolje, parafjalë). *Shembull:* Dog (emër), run (folje), happy (mbiemër), quickly (ndajfolje).

**Pragmatika:** Disiplinë që studion përdorimin e gjuhës në situata specifike komunikimi. Në kontekstin arsimor, lidhet me përdorimin e gjuhës të varur nga konteksti. *Shembull:* Could you open the window? (pragmatikisht një kërkesë e sjellshme, jo pyetje).

**Prozodia (intonacioni):** Përfshin karakteristikat ‘muzikore’ të gjuhës: ritmin, theksin, tonin, pauzat. *Shembull:* Të ngjiturit e tonit në fund të ‘Really?’ sinjalizon pyetje.

**Segmentimi:** Procesi i ndarjes së njësive gjuhësore në elementë më të vegjël (tinguj, shkronja, rrokje). *Shembull:* butterfly → butter + fly.

**Semantika:** Studion kuptimin e shprehjeve gjuhësore. Konteksti përcakton kuptimin specifik. *Shembull:* krah = gjymtyrë e trupit; krah = mbështetje (p.sh. në shkollë).

**Sinonimia:** I referohet ngjashmërisë ose barazisë në kuptim të shprehjeve të ndryshme. *Shembull:* big → large → huge.

**Teknika:** Në kontekstin e mësimdhënies i referohet veprimeve metodike si shpjegimi, motivimi dhe monitorimi. *Shembull:* Mësuesi përdor teknikën e pyetjeve për të aktivizuar njohuritë paraprake.

**Transferimi:** Transferimi i njohurive ose aftësive në kontekste të reja. *Shembull:* Përdorimi i teknikave narrative të mësuara në një përrallë për të shkruar një histori personale.

## Literatura e përdorur

Bussmann, Hadumod (2008). *Lexikon der Sprachwissenschaft [Enciklopedia e gjuhësisë]*. Stuttgart: Kröner.

Council of Europe (2001). *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment [Korniza e përbashkët evropiane e referencës për gjuhët: të nxënit, mësimdhënia, vlerësimi]*. Strasbourg / Langenscheid.

Harris, Michael; Mower, David; Sikorzynska, Anna & White, Lindsay (2012)(Ed.). *New Challenges 1-3*. London: Peason ELT.

*Kurrikula e Republikës së Shqipërisë*. Online: <https://www.ascap.edu.al/kurrikula-e-perditesuar-2025>

*Kurrikula e Republikës së Kosovës*. Online: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

*European Language Portfolio ESP [Portofoli evropian i gjuhëve]* (2005). Bern: Schulverlag plus.

*Lingualevel. Instruments for the evaluation of foreign language competences [Lingualevel. Instrumente për vlerësimin e kompetencave në gjuhët e huaja]* (2007). Bern: Schulverlag bmlv.

Schader, Basil (2016). *Series “Materials for heritage language teaching” (HLT; in Switzerland HSK: Instruction in native language and culture); Handbook and workbook [Seria “Materiale për mësimdhënien e gjuhëve të trashëgimisë” (HLT; në Zvicër HSK: Mësim në gjuhën dhe kulturën amtare); Libër udhëzues dhe libër pune]*. Linku: <https://myheritagelanguage.com/books/>

Selimi, Naxhi (2021). *Bildungssprache Deutsch und ihre Didaktik. Eine kompakte Einführung in Theorie und Praxis (4. Aufl.) [Gjuha e arsimit dhe didaktika e saj. Hyrje në teori dhe praktikë]*. Baltmannsweiler: Schneider Hohengehren.

*Sprachgewandt 2.-9. Klasse [Sprachgewandt – klasa e 2-të deri në klasën e 9-të]* (2013). Zurich: Lehrmittelverlag.

Young Stars 1-6. Link: <https://www.mmpublications.com/Primary/Young-Stars-British>

## Mirënjohje

Falënderojmë të gjithë mësuesit/-et dhe nxënësit/-et që e testuan instrumentin. Prof. em. Dr. Dr. Basil Schader, Prof. Dr. Brikena Kadzadej, Prof. Asoc. Dr. Florinda Tarusha dhe Dr. Spiro Paço i falënderojmë për shqyrtimin e draftit dhe përmirësimin e cilësisë së tij në përputhje me pritshmëritë e instrumentit. Për korrigjimin gjuhësor të dokumentit e falënderojmë M.A. Nuhi Gashi, kurse për realizimin grafik M.Sc. Ina Lushka. Programin READ (Research Expertise from the Academic Diaspora) e falënderojmë për mbështetjen financiare dhe mbikëqyrjen e procesit, kurse Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’, Durrës dhe Universitetin e Edukimit Schwyz për mbështetjen ideore dhe materiale.

## Shënime për autorët:

*Prof. Dr. Naxhi Selimi* është mësues i licencuar për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë. Ai ka studiuar gjuhësi, ka kryer studimet e magjistraturës në gjuhësi dhe letërsi, ndërsa doktoraturën dhe postdoktoraturën i ka mbrojtur në shkencat e edukimit, gjuhësisë dhe kulturës. Aktualisht është profesor i didaktikës së gjermanishtes në Universitetin e Edukimit Schwyz (Zvicër). Fushat e tij kryesore të punës shkencore përqendrohen në gjuhësi, përvetësimin e fjalorit në mjedise shumëgjuhëshe, të folurit dhe të shkruarit në gjuhën e edukimit, diagnostikimin gjuhësor, zhvillimin e gjuhës në fëmijërinë e hershme, si dhe në hartimin e materialeve mësimore dhe instrumenteve gjuhësore. Kontakti: [naxhi.selimi@phsz.ch](mailto:naxhi.selimi@phsz.ch)

*Prof. Asoc. Dr. Emilda Roseni* është lektore në Departamentin e Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Edukimit të Universitetit ‘Aleksandër Moisiu’ në Durrës. Me përvojë akademike që prej vitit 2009, ajo është specializuar në mësimdhënien e gjuhës angleze, metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, edukimin ndërkulturor dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Ka botuar artikuj shkencorë në revista të indeksuara dhe në konferenca ndërkombëtare, si edhe tekste akademike me fokus në didaktikë, menaxhim klase, përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Kontakti: [emildaroseni@uamd.edu.al](mailto:emildaroseni@uamd.edu.al)

*Prof. Asoc. Dr. Shqipe Haxhihyseni* është pedagoge në Departamentin e Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit të Universitetit ‘Aleksandër Moisiu’ në Durrës, me mbi tridhjetë vite përvojë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Ajo ka punuar si mësuese, psikologe shkollore, lektore dhe eksperte e jashtme për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe ka marrë pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e praktikave mësimore. Interesat e saj akademike përfshijnë zhvillimin e kurrikulës, metodologjitë e mësimdhënies, aftësitë e të nxënësve dhe edukimin gjithëpërfshirës. Ajo është autore e teksteve shkollore, monografive dhe artikujve shkencorë. Në vitin 2024 botoi abetaren *Oplala me ABC*. Kontakti: [shqipehaxhihyseni@uamd.edu.al](mailto:shqipehaxhihyseni@uamd.edu.al)

